



RAPORT PËRFUNDIMTAR
AUDITIMI

“MBI AUDITIM FINANCIAR DHE
TË PËRPUTHSHMËRISË”

SUBJEKTI BASHKIA KONISPOL

Tiranë, 2023

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4-17
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	4-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve.....	4-15
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimit.....	15-17
II	HYRJA	17-21
	a. Objektivat e auditimit.....	
	b. Qëllimi i auditimit.....	
	c. Identifikim i çështjes.....	
	d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	
	e. Përgjegjësitë e Audituesve.....	
	f. Kriteret e vlerësimit	
	g. Standardet e auditimit.....	
	h. Metodatat e auditimi	
	i. Dokumenti i auditimit.....	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.	21-116
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim..	21-24
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit...	24-
2.1	<i>Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm; Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.</i>	24-33
2.2.	<i>Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.</i>	33-39
2.2.6	<i>Mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre.</i>	39-45
2.3	<i>Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.</i>	45-61
2.4	<i>Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.</i>	61-73
2.5	<i>Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit</i>	73-75
2.6	<i>Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)</i>	75-76
2.7	<i>Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.</i>	76-102
2.8	<i>Të ndryshme të dala gjatë auditimit</i>	
III.	KONKLUZION I PËRGJITHËHM DHE OPINIONI I AUDITIMIT.....	102-116
IV.	GJETJE DHE PËR KËTË REKOMANDOJMË.....	102-116
V.	ANEKSE.....	117-129

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standartet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI-t	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), në periudhën nga data 24.04.2023 deri në datë 26.05.2023, në subjektin Bashkia Konispol, për periudhën nga 01.01.2022 deri në 31.12.2022, u krye auditimi me objekt “*Mbi auditimin financiar dhe përputhshmëri*” duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxhetit; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore; auditimin me zgjedhje i transaksioneve financiare, hartimin e pasqyrave financiare viti 2022, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike dhe menaxhimit të të ardhurave, etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë periudhës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë në KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, shpërblim të dëmit, mungesë së të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet të fondeve publike (3-E), i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Konispol për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022, grupi i auditimit konkludon në një opinion të **modifikuar/kualifikuar** për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2022), ndërsa për aspektin e përputhshmërisë për të ardhurat dhe shpenzimet ka dalë me opinion të **modifikuar/kualifikuar**.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raport Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1.	Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, rezultojnë se: Rregullorja e Brendshme nuk është plotësisht në përshatje me strukturën organike aktuale, pasi	E Lartë	24-33	Kryetari i Bashkisë Konispol, me atributet e Kryetarit të GMS, si dhe Nëpunësi Autorizues dhe Koordinatori i Riskut, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>mungojnë përcaktimet e detyrave dhe përgjegjësi të Sektorit të Menaxhimit të Aseteve. Kështu në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Blegtorisë është shtuar pozicioni “Inspektor për mbrojtjen e konsumatorit” dhe në Drejtorinë Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit, janë shtuar pozicionet “Specialist inxhinier hidroteknik” dhe “Sekretar i sekretarisë teknike”, pozicione të cilat mungojnë në rregullore. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:</p> <p><u>“Mjedisi i kontrollit”</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të Brendshëm. Nga 3 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. <p><u>“Menaxhimi i Riskut”</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. - Mungon urdhri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. - Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut. - Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut. - Nuk janë hartuar planet e veprimit për menaxhimin e riskut - Nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. - Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. <p><u>“Aktivitetet e Kontrollit”</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungon sistemi i “IT” dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (BACK-UP) - Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar “IT” të ndryshme në sektorë të ndryshëm, si dhe nuk ka plan investimesh për programet e “IT”. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. 			<p>dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakt. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p><u>“Informimi dhe komunikimi”</u> - Sistemi i raportimit, nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisive të varësisë të saj.</p> <p><u>“Monitorimi”</u> - Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakt dhe produkti. - Rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. - Aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës, veprime në kundërshtim me ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8 pika 8 shkronja (d, e), Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.</p>			
2.	<p>Nga auditimi mbi hartimin dhe funksionimin e strukturës organike të Bashkisë Konispol, nuk gjejmë të pasqyruar strukturën e Auditit të Brendshëm (AB), kjo për mungesë të specialistëve dhe nuk ka lidhur as aktmarrëveshje me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja (c), si dhe nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6 shkronja (a).</p>	E Lartë	24-33	<p>Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Konispol, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Sarandë ose Dropull.</p>
3.	<p>Nga auditimi rezultoi se buxheti në fillim të vitit është planifikuar për vlerën 177,584 mijë lekë . Gjatë vitit buxheti është shtuar për vlerën 182,179 mijë lekë pra plani sipas thesarit është për vlerën gjithsej 359,763 mijë lekë, gjë që tregon se në planin fillestarë këto fonde nuk janë marrë në konsideratë, të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së koston së produkteve, në një mjet jo real, të qëndrueshëm dhe efektiv. Realizimi i buxhetit sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2022 nga 359,763 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 317,716 mijë lekë ose në masën</p>	E Mesme	33-39	<p>Bashkia Konispol, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>88 %, . Detyrimet e papaguara për vitin 2022 sipas bilancit janë në shumën 14,756,764 lekë ose në masën 6.48 % të shpenzimeve të planifikuara, ku peshën më të madhe e zënë detyrimet për energjinë elektrike, telefon pastrimin në vlerën 12,208,920 lekë ose 83 % e totalit. Për vitin 2022 nuk janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetimit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42, me Udhëzimin e MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3</p>			<p>veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.</p>
4	<p>Nga auditimi rezultoi se gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 4,420,879 lekë si në mbyllje të bilancit të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022, aktive për të cilat nuk është kryer inventar fizik, referuar Inventarit kontabël vlera 1,598,199 lekë që i përket gjendjes së aktiveve të kësaj llogarie në Aparatin e Bashkisë në vlerën 976,468 lekë, shkollat e Bashkisë Konispol në vlerën 336,193 lekë dhe NJA Xarrë në vlerën 285,538 lekë. <u>Në gjendjen e llogarisë 32 “Inventari i imët ” sipas inventarit kontabël të NJA Markat, e cila paraqitet në një vlerë sintetike prej 2,822,680 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.</u> Kjo situatë është trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Konispol i bilancit të vitit 2015 të mbylljes së ish-komunës Konispol i paraqitur me probleme dhe pa analiza për këto aktive.</p>	E Mesme	45-61	<p>Drejtoria e Ekonomike të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël të aktiveve të pasqyruara në llog. 32 “Inventari i imët” për shumën 4,420,879 lekë, të bëhet inventarizimi si dhe të nxirren diferencat mes vlerave në kontabilitet dhe vlerave të inventarit fizik, të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore mbështetur në UMF.</p>
5	<p>Nga auditimi rezultoi se Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 29,902,017 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 35,189,198 lekë, me rritje për vlerën 5,287,181 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për</p>	E Mesme	45-61	<p>Drejtoria e Financë të marrin masa për kontabilizimin e masave shpërblim dëmi të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dërguar në Bashkinë Konispol me shkresat përkatëse.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët, sipas akt akordimit midis Sektorit të Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike. Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” konstatohet se Drejtoria e Financës nuk ka bërë kontabilizimin e detyrimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas Vendimit të Kryetarit të dërguara në Bashkinë Konispol edhe pse kanë dalë urdhër zhdëmtimeve përkatëse, të dala nga Kryetari i Bashkisë sipas planit të veprimit. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93.</p>			
6	<p>Nga auditimi rezultoi se llogarit 210 <i>“Toka, Troje, Terrene”</i>, paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 24,011,454 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 24,011,454 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b <i>“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”</i> në mbyllje të vitit 2020 dhe vitit 2021 në të njëjtën vlerë prej 24,011,454 lekë, 211 <i>“Pyje, Plantacione”</i> paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B <i>“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”</i>, si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 0 lekë. Për këto vlerë nuk ka analiza dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjithashtu në vlerat e tyre nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar Bashkisë Konispol dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative “Xarrë” dhe “Markat”. <i>Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</i></p>	E Mesme	45-61	<p>Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 <i>“Toka, Troje, Terrene”</i> dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
7	<p>Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” ,si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 0 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës këtë llogari ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale. <i>Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.</i></p>	E Mesme	45-61	<p>Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.</p>
8	<p>Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 383,664,972 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 368,221,963 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 497,239,440 lekë. Për këto AAGJM nuk është kryer inventar fizik. Në gjendjen së llog.212“Ndërtesa” është vlera kontabël e cila është e pa analizuar aktiv për aktiv. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Markat si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë Konispol. <i>Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”</i></p>	E Mesme	45-61	<p>Kryetari I Bashkisë Konispol, të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<i>pika 30.</i>			
9	<p>Referuar të dhënave për procedurat e zhvilluara për vitin 2022, gjithsej 5 procedura, me fond limit në vlerën 88,713 mijë lekë, mbi bazën e materialitetit u vlerësuan për aditim audituan 3 procedura me fond limit 30,564 mijë lekë, u konstatua se:</p> <p>a- Në 3 procedura raste me fond limit 30,564 mijë lekë, pasi kriteret e aplikuara janë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe me tipologjinë e procedurës së zhvilluar, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura.</p> <p>-Procedura me objekt “Zgjerim i varrezave te fshatit Mursi”, me vlerë të fondit limit 4,108 mijë lekë dhe vlerë kontrate 3,405 mijë lekë;</p> <p>-Procedura me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor, Konispol”, me vlerë të fondit limit 8,917 mijë lekë dhe vlerë kontrate 7,678 mijë lekë;</p> <p>-Procedura me objekt “Mbrojtje lumore në lumin “Pavëll” pranë urës së Bogazit”, me vlerë të fondit limit 17,539 mijë lekë dhe vlerë kontrate 14,153 mijë lekë;</p> <p>b- Në 2 procedura prokurimit, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DST dhe dispozitave të LPP. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurën tjetër me kushte me të favorshme., konkretisht:</p> <p>-Procedura me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor, Konispol”, me vlerë të fondit limit 8,917 mijë lekë dhe vlerë kontrate 7,678 mijë lekë;</p> <p>-Procedura me objekt “Mbrojtje lumore në lumin “Pavëll” pranë urës së Bogazit”, me vlerë të fondit limit 17,539 mijë lekë dhe vlerë kontrate 14,153 mijë lekë;</p>	E Lartë	61-73	<p>Kryetari i Bashkisë Konispol, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikave të zhvillimit të procedurave me një OE.</p> <p>Kryetari i Bashkisë Konispol, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik.</p>
10	<p>Për vitin 2022 rezultoi se: Bashkia Konispol, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2022 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjetës Kanalizime Konispol SHA me NUIS “LV” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt</p>	E Mesme	45-61	<p>Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjetës Kanalizime Konispol Sh.a me vlerë 299,600,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 299,600 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 299,600,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Konispol në “Ujësjiellës Kanalizime Konispol SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël të vitit 2022, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materialë” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.			
11	Nga analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, konstatohet se Drejtoria e Financës nuk disponon listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje”, nuk jep informacion të plotë, pasi mungon afati i fillimit dhe mbarimit të garancisë së vlerës 5% të punimeve për subjektet private. Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende. Në pasqyrat financiare të vitit 2022 vlera e llogarisë 466 është në vlerën 16,373,031 lekë sipas aneksit nr. 7 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50.	E Mesme	45-61	Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.
12	Nga auditimi ka rezultuar se me procesverbal nr. 06.01.2023, datë 25.8.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 2 OE, me PV datë 16.01.2023 nga KVO është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, ku në fund KVO ka vendosur kualifikimin e të dy OE, duke shpallur fitues shoqërinë “JD” shpk me ofertë 13,834,205 lekë pa TVSh me ofertë më leverdishme. me datë 18.01.2023 është bërë njoftim klasifikimi dhe ngarkuar në sistemin njoftimi i fituesit në zbatim	E lartë	61-73	Drejtoria e Financës/Buxhet, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e sigurimit të ofertës në vlerën 276,684 lekë .

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	të nenit 32, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021. Pas publikimit në APP të njoftimit paraprak të fituesit dhe në pritje së afateve të ankimimit OE “JD” shpk është tërhequr nga oferta nëpërmjet një mesazhit në sistemin datë 28.01.2023. Nga Bashkia Konispol (Sektori i prokurimeve dhe financës), nuk është vepruar për konfiskimin e sigurimit të ofertës, veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e bashkisë për shumën 276,684 lekë			
13	Në auditimin e kryer në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga ASHK, Dega Rajonale Sarandë, u konstatua se. Për periudhën objekt auditimi (01.01.2022 – 31.12.2022), kanë paraqitur kërkesë për pajisje me vërtetim mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, gjithsej 7 persona për vlerë takse të llogaritur prej 195,900 lekë, nga e cila deri me datë 31.12.2022 kanë paguar detyrimet 7 persona me vlerë 195,900 lekë. Referuar periudhës përpara vitit 2022 rezulton se gjendja debitorë ngelet e pa ndryshuar. Pra nuk kanë paguar detyrimin 11 persona me vlerë 246,548 lekë , e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Konispol. Paraqitet sipas aneksit nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Konispol, personat përgjegjës, nuk është bërë asnjë njoftim drejtuar ASHK Dega Sarandë, për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet nëse është marrë ose jo certifikatë pronësie. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, neni 23, pika 2/1 e nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar.	E lartë	39-45	Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej 246,548 lekë ndaj 11 personave .
14	Gjatë auditimit, u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (<i>sepse pavarësisht se mund ta kenë si</i>	E lartë	39-45	Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 1,500,000 lekë nga 2 subjektet, <i>respektivisht;</i>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas), në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.</p> <p>Në këtë njësi vendore operojnë tre subjekte të tregimit të karburanteve, <i>respektivisht</i>:</p> <p>1. Subjekti “L” ShPK me përfaqësues ligjorë z. D.K, pajisur me autorizim nr. 01, datë 25.6.2020. Sipas të dhënave në dosje, rezulton se nga vlera 1,000,000 lekë është arkëtuar vlera prej 1,000,000 lekë (konferma datë 8.6.2020 dhe 27.07.2020).</p> <p>2. Subjekti “H” ShPK me përfaqësues ligjorë z. TH.H, është pajisur me autorizim nr. 03, datë 7.10.2021. Sipas të dhënave në dosje, rezulton se nga vlera 1,000,000 lekë është arkëtuar vlera prej 500,000 lekë (konferma datë 10.9.2021), duke mbetur për detyrim shuma prej 500,000 lekë, si mungesë të ardhurash.</p> <p>3. Subjekti “I” ShPK me përfaqësues ligjorë z. P.I. Nga të dhënat e dosjes, rezulton se subjekti ka autorizim nr. 4, datë 10.5.2015 nga ish- Komuna Markat nuk është pajisur me autorizim të ri. Nga Sektori i taksave me shkresën nr. <i>ekstra</i>, i është bërë kërkesë për paisje me liçensë tregtimi të karburanteve, por nuk është bërë i mundur arkëtimi i vlerës prej 1,000,000 lekë, vlerë e cila konsiderohet mungesë të ardhurash në buxhet, si dhe lejimin e ushtrimit të aktivitet pa liçensë.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 ndryshuar me VKM nr. 970, datë 2.12.2015¹.</p>			<p>- vlera 500,000 lekë nga subjekti “H” ShPK;</p> <p>- vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “I” ShPK.</p>
15	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga punonjësit e bashkisë për dhënie me qira të pasurive të institucionit të qeverisjes vendore dhe konkretisht kontratat e qirave të lidhura midis Bashkisë Konispol dhe shoqërive private të telefonisë celulare si “V.A” sh.a, dhe të shoqërisë “A” (T. A) sh.a, për periudhën objekt auditimi, në lidhje me mënyrën e lidhjes së kontratave, të përcaktimit të tarifave, të arkëtimit të detyrimeve nga dhënia e objekteve të ndryshme me qira rezulton se nga ana e Bashkisë Konispol dhe ish Komunës Markat sot Njësi Administrative e Bashkisë</p>	E lartë	39-45	<p>Sektori Shërbimeve Tatimpaguesve Bashkia Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktual të palikujduara nga shoqëria “V.A” në vlerën 1,475,000 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.</p>

¹ “9. Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10. Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera”.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>Konispol, janë lidhur 3 kontrata qiraje, rezulton se jo të gjitha kompanitë kanë likujduar detyrimet sipas kontratave të lidhura, ku kompania private “V.A” sh.a, nuk janë kryer rregullisht pagesat në masën 100%, duke evidentuar një të ardhura të munguar në shumën 1,475,000 lekë nga kompania “V.A”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e qirasë nr.123 Rep, nr.33/3 Kol, datë 02.02.2015.</p>			
16	<p>Nga informacioni i paraqitur nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol dhe auditimi i tyre, u konstatua se gjendja e debitorëve sipas periudhave objekt auditimi është si vijon: Gjendja e debitorëve më 31.12.2021 është në shumën 29,902,017 lekë kjo për 1707 subjekte/familje, ku debitorët familjarë zënë 86.2% të totalit të debitorëve, gjë e cila tregon se nga Zyra e taksave Konispol nuk punohet në drejtim të arkëtimit të tyre në zbatim të dispozitave ligjore dhe mundësive të gjetjes së rrugëve, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Konispol.</p> <p>Në krahasim me vitin 2021, gjendja e debitorëve vjen në rritje, ku në fund të vitit 2021 vjen në vlerën 29,901,987 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 35,189,198 lekë ose me rritje në vlerën 5,287,211 lekë.</p> <p>Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, sipas dokumentacionit për arkëtimin e detyrimeve, ka zbatuar vetëm procedurën e njoftimit të subjekteve dhe asnjë procedurë tjetër në zbatim të procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve, veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhura për Bashkinë Konispol, në vlerën 35,189,198 lekë për vitin 2022.</p> <p>Gjithashtu, nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve nuk është vijuar me procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, ku rezultojnë se 48 subjekte debitorë (fizik/juridik) me vlerë 4,786,393 lekë, janë debitorë në vite. Në kundërshtim me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-<i>Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar</i>, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së</p>	E lartë	39-45	<p>Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën 35,189,198 lekë, si më poshtë vijon:</p> <p><i>a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.</i></p> <p><i>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.</i></p> <p><i>c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i></p> <p><i>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</i></p> <p><i>e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Sarandë për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.</i></p> <p><i>f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.</i></p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 - <i>Mospagimi i taksave dhe tatimeve</i> ² , apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), duke u bërë përgjegjës për rritjen e nivelit të borxhit.			

I.2. Konkluzioni dhe Opinionit i Auditimit.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (balance) të vitit 2022, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **“Opinion të modifikuar/kualifikuar”**, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit arrijmë në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë përmbledhëse vjetore të konsoliduar të vitin 2022.

- Në auditimin e përputhshmërisë në fushën e shpenzimeve operative (602), investimeve (231), të fondit të pagave (601) dhe menaxhimit e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Konispol bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar disa anomali materiale por jo të përhapura, që janë baza për dhënien e një **“Opinion të modifikuar/kualifikuar”**, pasi kriteret nuk janë vendosur në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe se OE/BOE të shpallur fitues nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST miratuara nga AK, në mos zbatimin e plotë të procedurave ligjore në arkëtimin e debitorëve me vlerë 35,189 mijë lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë Konispol.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2022:

Objektivi i Audituesve në auditimin financiar është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nëse këto pasqyra janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduar të Bashkisë Konispol për vitin e fundit ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit arrijmë në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë përmbledhëse vjetore të konsoliduar të vitin 2022, të cilat justifikojnë dhënien e **opinionit të modifikuar/kualifikuar, të shprehura tek baza për opinionin.**

Baza për dhënien e opinionit të auditimit

² “Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit mbi shpenzimet prej *5,147 mijë lekë*, si dhe anomalitë e konstatuara të përshkruara në vijim. Gjithashtu ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të modifikuar/kualifikuar të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë:

- Nga testimi i llogarive, konstatohet se sipas inventarit kontabël përfshihen vlera të pa analizuar për të cilat mungon inventari fizik e regjistri i aktiveve, si: llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” me vlerë 24,011,454 lekë, aktiveve që i përkasin ish-Komunës Markat, në llog. 32 “*Inventari i imët*” me vlerë 4,420,879 lekë; në llog 212 “*Ndërtesa Konstrukione*” me vlerë 368,221,963 lekë; llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” me vlerë 1,363,847,293 lekë.

-Drejtoria e Financës nuk disponon listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “*Kreditor për mjete në ruajtje*” në vlerën 16,373,031 lekë, pasi mungon afati i fillimit dhe mbarimit të garancisë së vlerës 5% të punimeve për subjektet private

- Llogaria 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*” është nënvlerësuar në vlerën 299,600,000 lekë.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Konispol, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të **modifikuar (kualifikuar)** të përputhshmërisë, *të shprehura tek baza për opinionin.*

Baza për dhënien e opinionit

- Bashkia Konispol nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë marrë masa të plota për uljen e detyrimeve të prapambetura. Edhe pse janë likuiduar gjatë vitit buxhetor detyrime të prapambetura, nga ana tjetër edhe gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura, duke çuar në 31.12.2022 vlerën e tyre, me burim financimi të ardhurat e veta në 14,756 mijë lekë.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të lartë, konstatohet se në **3** procedura me fond limit 30,564 mijë lekë, kriteret nuk janë mirëargumetuara dhe në përputhje me tipologjinë e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura ose skualifikim e OE me oferta të leverdishme

b- Në 2 procedura prokurimit, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DST dhe dispozitave të LPP. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurën tjetër me kushte më të favorshme.

- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2022 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej 35,189 mijë lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Konispol, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Konispol:

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi

është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Konispol.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kritereve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 315/1, datë 19.04.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 24.04.2023 deri në datë 26.05.2023, në subjektin Bashkia Konispol, për periudhën nga 01.01.2022 deri në 31.12.2022, u krye auditimi me objekt “*Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërie*” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. P. Gj., *Përgjegjës Grupi*
2. H. I., *antarë,*
3. V. Sh., *antarë,*
4. M. M., *antarë,*
5. K. F., *antarë.*

a- Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

• Objektivat e auditimit synojnë:

Për auditimin **financiar**, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e **përputhshmërisë**, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrin ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e Audituesve:

-Nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullat dhe ligjet e kontabilitetit;

-Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

-Nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-Verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;

- Auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

b- Procedura e ndjekur: Raport Auditimi i dërgohet subjektit Bashkia Konispol, pasi nga subjekti i audituar me shkresën nr. 758, datë 14.07.2023 (*prot KLSH nr. 315/4, datë 18.07.2023, nr 315/5, datë 21.07.2023*), është dërguar Projekt Raportin e Auditimit pa observacione, dërguar në subjekt me shkresën nr. 315/3, datë 16.06.2023. Gjetjet e konstatuara nga grupi i KLSH, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Auditim, i cili i përcillet subjekti për zbatim dhe përmisimin e gjendjes në të ardhmen, referuar kjo dhe rekomandimeve të KLSH të reflektuara në fund të raportit.

c- Identifikimi i çështjes: Ky Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Konispol, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

d- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit).

Strukturat drejtuese të Bashkisë Konispol janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe në të njëjtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të Bashkisë në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për planifikimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e territorit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

e- Përgjegjësitë e Audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Konispol dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

f- Kriteret e vlerësimit.

✓ Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ✓ Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- ✓ Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së ndryshuar me nr. 63, datë 22.6.2020;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi “Auditimin e përputhshmërisë”, Manualët e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”;
- ✓ Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje;
- ✓ Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 26, datë 27.12.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006”;
- ✓ Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.
- ✓ Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”; etj. dhe kuadri rregullues i brendshëm i bashkisë.

g- Standardet e auditimit:

- Auditimi është kryer sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI.
- ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
 - ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*” që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
 - ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200;
 - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
 - Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.
 - Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

h- Dokumentimi i rezultateve të auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre

konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

I- Praktikrat e ndjekura në kryerjen e auditimit. Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga (600), shpenzimet operative (602) dhe shpenzimet për investime (231).

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/ procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; *dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

k- Metodrat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

- **Metoda e Auditimit:** Auditim mbi bazë risku.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i Përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Konispol u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës *materiale po jo të përhapura*, si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E, në fushën e prokurimeve dhe menaxhimit të të ardhurave, *materiale po jo të përhapura*.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, të reflektuara në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve.

Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar dhe paraqitur nga subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP, për

realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Konispol është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Konispol.

1. Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Profili i Bashkisë Konispol

Bashkia Konispol kufizohet në veri me Bashkinë Finiq, në perëndim me Bashkinë Sarandën dhe në jug me Greqinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Konispolit.

Kjo bashkia kë 3 njësi administrative si: NJA Xarrë, NJA Markat dhe NJA Konispol



- Të dhëna të përgjithshme

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011, Bashkia e re Konispol ka një popullsi prej 8245 banorësh ndërsa sipas regjistrimit civil ka 13737 banorë. Sipërfaqja e bashkisë së re është 221.88 km². Densiteti i popullsisë është 37.1 banorë për kilometër katror ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 61.91 banorë/km².

Bashkia Konispolit ka si aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe blegtorinë, si dhe tregtinë ndërkuftare me Greqinë. Një pjesë e popullsisë shërben në sektorin e transportit për qëllime turistike në Konispol ose për transportin ndërkuftar, ndërsa një pjesë e popullsisë kalon kufirin rregullisht për të punuar përkohësisht në zonat pranë kufirit në Greqi.

Bujqësia është e përqendruar te agrumet, ullinjët dhe vreshtat, ndërsa zona është e famshme edhe për kullota dimërore për bagëtinë e imët.

Infrastruktura e zonës është sistemuar me ndërtimin e rrugëve lidhëse, si dhe me rrugën drejt pikës kuftare të Qafë-Botit.

Bashkia ka në territorin e saj një vijë bregdetare prej rreth 10 kilometra të gjatë e cila aktualisht është e pazhvilluar përreth “Kepit të Stillos”. Në këtë pjesë të bregdetit gjenden mes të tjerash “Ishulli i Tongos”, një shkëmb me sipërfaqe prej rreth 5 mijë metrash katrore pranë Gjirit të “Ftelias”, në kufi me Greqinë, si dhe Ishulli i “Stilit”, për të cilën bashkia nuk ka mundur të krijojë guida turistike për promovimin e zonës dhe sigurimin e të ardhurave në favor të buxhetit të Bashkisë Konispol.

- Sfidat me të cilat do të përballë pushteti vendor.

Krijimi i mundësive për zhvillimin e turizmit në pajtim me natyrën përgjatë bregut të detit kërkon investime publike si dhe planifikim të mirë dhe transparent të zhvillimit.

- Parimet e auditimit financiar:

Në punën tonë jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- *Etika dhe pavarësia;*
- *Kontrolli i cilësisë*
- *Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre*
- *Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.*

- Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitetet, pasivitetet dhe interesat e kapitalit janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

- **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese.**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

- **Objekti i këtij auditimi**, është raportimi financiar dhe paraqitja e drejtë dhe e sinqertë e pasqyrave financiare për vitin 2022. Gjithashtu, sipas programit të auditimit, objekt i këtij auditimi është edhe vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të subjektit të audituar me kriteret e vlerësimit në procedurat e prokurimit dhe menaxhimit të ardhurave nga taksat/tarifat vendore.

- **Qëllimi i auditimit**, është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidencat të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (**ISSAI 1315**)⁴.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

- **Fushëveprimi i këtij auditimi**, përfshin të gjithë aktivitetin e Bashkisë Konispol. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, duke vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin

⁴Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Konispol.

- **Misioni**, për njësinë që auditohet është kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grantin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin*).

- **Objektivat**, burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak.

Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë

Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre.

Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimit të pikave të programit të auditimit nr. 315/1, datë 19.04.2023.

Pika 1.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditim e brendshëm.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmërisë të shërbimeve publike, si dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- *pajtuëshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;*

- *informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;*

- *mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.*

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Konispol, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

Titulli i Gjetjes: *KLSH ka konstatuar se në Bashkinë Konispol funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka shfaqur mangësi, duke sjellë që fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht. Për ta përmirësuar atë në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.*

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njesisë, pasi ky institucion është duke shkuar drejt konsolidimit, por nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Rregullorja e Brendshme nuk është plotësisht në përshatje me strukturën organike aktuale, pasi mungojnë përcaktimet e detyrave dhe përgjegjësi të Sektorit të Menaxhimit të Aseteve. Në Drejtorisë së Bujqësisë dhe Blegtorisë është shtuar pozicioni Inspektor për mbrojtjen e konsumatorit dhe në Drejtorinë Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit janë shtuar pozicionet specialist inxhinier hidroteknik dhe sekretar e sekretarisë teknike, pozicione këto të cilat mungojnë në rregullore. Rregullorja në përgjithësi ka përpjekje për të përfshirë një tërësi rregullash e procedurash për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar edhe kompetencave e akteve nënligjore në fuqi. Në Rregullore nuk janë përfshirë rastet e konfliktit të interesit si dhe nuk janë përcaktuar procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

I. “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

- Bashkia Konispol ka të miratuar një Rregullore të Brendshme për parandalimin e Konfliktit të interesit, respektivisht në nenin 39 janë përfshihen rastet e konfliktit të interesit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Njohjen e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria Juridike, por nuk ka trajnime për këto raste.

- Bashkia Konispol me shkresën nr. 10 datë 27.02.2020 ka Kod të Etikës, të cilat në nenin 35 të Rregullores së Brendshme, janë përfshirë rregulla e etikës për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion.

- Në Rregulloren e Brendshme në nenin 38 është përcaktuar procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive. Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkelje të kodit etik. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në zyrën e specialistit të burimeve njerëzore nëpërmjet zyrës së informacionit), duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë, i cili përcakton strukturën e cila do të trajtoj ankesat dhe kërkesat. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 30 “Kërkesat dhe Ankesat” të Rregullores së Brendshme.

- Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësi mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxheriale janë përcaktuar që në rregullore e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë për Titullarin (NA).Mungojnë raportet periodike, ndërsa për çdo

mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga 3 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

- Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 19 dhe 29, dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga Bashkia është plotësuar dhe dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave“ Pyetësorin e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm” për vitin 2022 me shkresën nr. prot. 249, datë 28.02.2022.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 *“Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”*

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA. Bashkia Konispol ka të hartuar Planin e Zhvillimit Strategjik. Në dokumentet e PBA-ve nuk ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kane marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve, për të cilat nuk disponohen procesverbale të takimeve të tyre. Po ashtu dhe për organizimet e tryezave të rumbullakëta me palët e treta si grupet e interesit, si dhe për dëgjesa me publikun nuk është mbajtur protokoll i veçantë, pavarësisht se kjo gjë është parashikuar në Rregulloren e brendshme neni 24 “Seancat e këshillimit”. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

- Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin, aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përcaktuar për çdo Drejtori misioni, objektivat, baza ligjore, po vetëm përbërja e strukturës, detyrat dhe përgjegjësitë, sektor dhe specialist. Ndërsa në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës.

- Bashkia Konispol ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për këtë njësi vendore.

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performancë.

Në lidhje me parimin 4 *“Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”*

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune por nuk janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, ku në Rregulloren e

Brendshme nuk përcaktohet procedura që duhet të ndiqet për rekrutimin dhe plotësimin e dosjes, dhe çfarë të dhënash e dokumentacioni duhet të përmbajë dosja e punonjësit. përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin. masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: çertifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; çertifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Gjithashtu nga Bashkia Konispol nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

- Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

Në lidhje me parimin 5 “ Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

Në Rregulloren e Brendshme janë përcaktuar rregulla për delegimin e detyrave dhe për periudhën objekt auditimi janë kryer delegime detyrash të cilat janë bërë në bazë të Ligjit nr. 139/2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore” neni 59, pika 3 me autorizimet dhe Urdhërata përkatës:

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësisë të Qeverisjes Vendore ”Titullari i bashkisë nga nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2022 me shkresën nr. Prot. 17 datë 12.01.2022 ka dalë urdhri i titullarit nr. 4 datë 12.01.2021 “Për ngritjen GMS dhe ekipeve të menaxhimit të programeve”. Në këtë urdhër është ngritur GMS me 7 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë (NA) dhe 4 ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA 2022-2024.

Në këto urdhra nuk janë përcaktuar se çfarë detyrash duhet të kryejë konkretisht këto grupe ose në rregulloren e Brendshme në Kreun 5 “Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë” nuk është përfshirë Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), me detyrat dhe përgjegjësitë.

- Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar

- Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë: Sistemi i menaxhimit

të burimeve njerëzore; sistemi i programimit të zbatimit të buxhetit; sistemi i pagesave, sistemi i prokurimeve me vlera të vogla dhe të larta; inventarët e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese; sistemi i tatim-taksave.

Në kapitullin “Vlerësimi i sistemit të MFK” janë përshkruar se sa janë arritur objektivat në fushat prioritare për bashkinë si në sektorin e shërbimeve publike, sektorin e bujqësisë dhe sektorin e tatim-taksave. Si ka ndikuar komponenti i informimit dhe komunikimit me procedurat me rregulloret e hartuara dhe të realizuara nga kjo njësi në arritjen e objektivave në sektorët më të rëndësishëm të veprimtarisë së bashkisë. Si ka funksionuar komponenti i monitorimit. Të kontrollit të brendshëm në cilësinë e performancës. Si ka ndikuar veprimtaria e AB në monitorimin e Kontrollit të brendshëm.

Gjithashtu janë paraqitur masat e marra për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe planveprimeve për të ardhmen për përmirësimin e performancës organizative dhe financiare të njësisë nga puna për arritjen e synimeve përkatëse të : Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm dhe Integritit Evropian, Drejtorisë së Bujqësisë dhe Blegtorisë, Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit, Administratës së Njësive Administrative Markat dhe Xarrë.

Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: *Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.*

Bashkia Konispol në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva si në planet operacional strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat kombëtare e sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë. Këto objektiva bëhen të njohura, duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe dëgjesa me publikun.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

- **Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut,** dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”*

Në Bashkinë Konispol nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Mungon urdhri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.

Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në bashki në të gjitha nivelet e saj , pra mungon regjistri i riskut. Duke mos u ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë hartuar as planet e veprimit për menaxhimin e riskut.

Në lidhje me parimin 8: *“Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.*

Duke mos patur një vlerësim të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe funksionimi i tij, por as në Rregulloren e Brendshme nuk është përfshirë si funksion “Koordinatori i Riskut”, ku të përcaktoheshin kushtet që duhet të plotësojë për të qenë një nëpunës koordinator risku, detyrat dhe përgjegjësitë etj.

Referuar këtij komponenti të MFK rezulton se nuk është realizuar. NA nuk ia ka deleguar këtë funksion ndonjë nëpunësi të Aparatit të Bashkisë bashkë me detyrat dhe përgjegjësitë që i takojnë këtij funksioni. Këto veprime e mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 9 pika 3, neni 10, neni 11 pika 2 .

Në lidhje me parimin 9: *“ Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.*

Bashkia Konispol në politikatat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

III. Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: *“ Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivite kontrolli”.*

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës të cilat i referohen edhe hartës së procese të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i financës/ Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA)

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Ngritja e këtyre komisioneve është parashikuar edhe në Kreun 4 të Rregullores së Brendshme

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.

- Në Rregulloren e Brendshme në Kreun IV “Kompetencat dhe detyrat e Administratës së Bashkisë” nenin 28 “*Organigramës e Bashkisë Konispol,*” faqja “Arkivisti” në detyrat dhe përgjegjësitë përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të nenit 42 “Ruajtja dhe administrimi i dokumenteve financiare” i ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

- Për menaxhimin e aktiveve rregullat janë identifikuar në rregulloren e brendshme në detyrat e Drejtorisë Ekonomike, por për menaxhimin e tyre veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. Mungon regjistri i aktiveve për çdo aktiv me përditësimet përkatëse. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave por, kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit materiale. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve. Aktivet Afatgjata nuk janë regjistruara në SIFQ, pasi kjo Bashki akoma nuk është pilot për aplikimin direkt në programin e Qeverisë SIFQ.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”

- Bashkia Konispol nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Në rregulloren e brendshme Kreu IV “Kompetencat dhe detyrat e Administratës së Bashkisë” nenin 28 “*Organigramës e Bashkisë Konispol,*” faqja “*Specialisti i IT*” përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të IT në varësi të Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, i cili ka detyra vetëm për mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe menaxhimin e programeve, nuk merret me instalimin e programeve. Faqja Zyrtare e bashkisë Konispol në internet ka një sistem back-up.

Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, përgjegjësi këto të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, por mungojnë plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Drejtuesit në Bashkinë Konispol kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Nuk janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit çdo 4-mujor dhe vjetor, me qëllim paraqitjen pranë këshillit bashkiak si dhe në Degën e Thesarit

- Raportet për detyrimet e konstatuara por të papaguara hartohen çdo 3 muaj dhe paraqiten në degën e thesarit.

- Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Konispol për mbetjen e kontabilitetit operon me program Excel, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij programi me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria Ekonomike. Gjithashtu edhe monitorimi i të ardhurave kryhet me program Excel të cilin e menaxhon Sektori i Tatim-Taksave.

Në lidhje me parimin 14: *Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm*

Në lidhje me parimin 15: *Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm*

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në kreun II “Organizimi i punës në Administratë në Bashkisë” nenin 13 “Praktika shkresore” neni 14 “Dokumentacioni dhe pajisjet” Kreu III “Funksionimi i Administratës së Bashkisë” neni 15 “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të Administratës së Bashkisë” 16 “Marrëdhëniet me Këshillin bashkiak” neni 17 “Marrëdhëniet me institucionet e tjera” neni 18 “Marrëdhëniet me publikun”, neni 22 “Marrëdhëniet me median” neni 20 “Kërkesat dhe ankesa”,

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo javë në takimet e kryetarit me bordin e drejtorëve, ku shqyrtohen e diskutohen të gjitha problemet e ndryshme të administratës për realizimin e funksioneve të bashkisë..
Mungojnë informacionet periodike të drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dhe analizave për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

Nuk është në përdorim emailit zyrtar komunikimi zyrtar mes menaxherëve dhe punonjësve të bashkisë realizohet përveç komunikimit verbal e shkresor si dhe nëpërmjet postës elektronike personale.

Nga bashkia Konispol kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të parashikuara dhe në rregulloren e brendshme, por mungon dokumenti i evidentimit të konsultimit publik të kryer.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: *“Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.*

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë Impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave.

- Në Bashkinë Konispol mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH, ndërsa nga Auditi i brendshëm nuk ka rekomandime, pasi nuk ka strukturë të ngritur. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se janë realizuar.

- Në Bashkinë Konispol aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Përformancës si dhe Komiteti i Auditimit.

- Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi nuk është ngritur si strukturë, duke sjellë mungesën e një elementi që luan rol të rëndësishëm në funksionin e monitorimit e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe në vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm .

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezentë në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

- Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditi i Brendshëm, ka bërë përpjekje për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet planveprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8 pika 8/d,e. Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016

Impakti: Mosnjohje e plotë dhe sa duhet i koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm

Shkaku: Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor

Rëndësia: I mesëm.

Rekomandimi

Kryetari i Bashkisë Konispol, me atributet e Kryetarit të GMS, si dhe Nëpunësi Autorizues dhe Koordinatori i Riskut, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë te programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakt. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Pika “1/3” Vlerësimi dhe aktivitetit i Auditit të brendshëm në sektorin publik

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve në VKM nr. 83, datë 03.02.2016” Për Miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” nuk ka gjetur zbatim në Bashkinë Konispol. Referuar Vendimit nr. 84, datë 30.05.2022, të Kryetarit të KLSH-së, për përmirësimin e gjendjes, është rekomanduar “Kryetari të Bashkisë Konispol të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Konispol, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Sarandë ose Dropull.

I/2-Vlerësimi dhe aktivitetit i Auditit të brendshëm në sektorin publik.

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në bashkinë Konispol nuk ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikat 3 dhe 6 të, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm” dhe ka si funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë e Konispol, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, germa “c” si dhe neni 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” *duke ngarkuar me përgjegjësi SH.B. në cilësinë e nëpunësit Autorizues.*

Kriteri: Veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja “c”, si dhe neni 64, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, të VKM nr.83, datë 03.02.2016, pika 6 shkronja “a”, “Për miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Impakti: Mungesa e strukturës së Auditit të Brendshëm, bën që Kryetari i Bashkisë Konispol të mos njihet me veprimtarinë e sektorëve për veprimet financiare që ato kryejnë.

Shkaku: Mungesa e personelit të kualifikuar për kryerjen e këtij shërbimi.

Rëndësia: *I mesëm*

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të bashkisë, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukture me personelin arsimor të kualifikuar, të shikohet mundësia e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkia Sarandë ose Bashkia Dropull.

Pika 2.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Programimi i PBA 2022-2024 dhe programimi i buxhetit vjetor 2022, 2023 dhe 2024.

- Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024 rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të Titullarit të institucionit, organizimin e mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e taveve të shpenzimeve sipas programeve të cilat janë miratuar përkatësisht me VKB nr.39 datë 25.11.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë 946/1, datë 09.12.2021.

- Janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, në rastin konkret ka pësuar rritje funksioni i planifikim, menaxhim administrimi dhe funksioni i gjelbërimit, ndërsa rritje më të vogël kanë pësuar rrugët rurale dhe arti-kultura. Është bërë analiza e për pagat dhe janë llogaritur peshat specifike e këtyre llojeve të shpenzimeve në totalin e shpenzimeve.

- Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime konkretisht në dy funksionet më të rëndësishme në infrastrukturën e brendshme rrugore, në vazhdimin e ndërtimit të rrugëve rurale në të gjitha NJA dhe në funksionin e ndricimit publik. Ndersa ne drejtim te furnizimit me uje te pijshem eshte fokusuar nga financimi i AKUK.

- Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzime korrente, investime dhe të ardhurat. Theksojmë se për investimet janë paraqitur në mënyrë të detajuar referuar dhe burimeve të financimit, kështu nga të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar janë projektuar për financim 3 investime ne infrastrukture rrugore dhe ndricim

publik. Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, ujsjellsit, etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Titulli gjetjes: Mbi programimin, realizimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi.

Për vitin 2022 buxheti është miratuar me VKB nr. 43, datë 22.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlore me shkresën nr.prot. 3/1 dt.17.01.2022

Miratimet e buxhetit fillestar të Bashkisë Konispol për vitin 2022 paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

Nr .	Emërtimi	në 000/lekë	
		Plani i vitit 2020	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara nga viti paardhës	3,000	
2	Transferte e pakushtëzuar	104,517	
3	Transferte e specifike		
4	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	68,067	
	Granti nga FZHR e M.linje		
5	Trashëguar nga transfertat	2,000	
6	Paga (600)		71,372
7	Sigurime shoqërore (601)		10,573
8	Shpenzime operative (602)		54,304
9	Transferta (604) F.ondi Rezerv		5,042
10	Fondi Veçantë		3,161
11	Inv(230 +231) nga ardhurat e Tr.pakushez		33,128
Totali i buxhetit		177,584	177,584

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se nga plani i të ardhurave për vlerën 177,584 mijë lekë, janë planifikuar shpenzime nga të ardhurat e veta në vlerën 71,067 mijë lekë dhe nga granditë në vlerën 106,517 mijë lekë.

-Në buxhetin e miratuar për vitin 2022, nuk janë programuar si zë më vete, likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës që sipas pasqyrave financiare për vitin 2021, janë në shumën totale 43,364,552 lekë ose 24% e buxhetit fillestar.

Mos programimi si zë më vete në buxhet të detyrimeve të vitit paraardhës, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 101 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit".

Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj.të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Gjithashtu gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet, pasi janë kryer shtesa dhe pakësime në artikuj të ndryshëm të buxhetit, sipas nevojave,ku në rastet e lvizjeve brenda të njëjtë artikull

dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me VKB.

- Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të regjistruara e të rakorduara me Degën e Thesarit Sarande dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndryshimet në buxhet gjatë vitit ushtrimor ndërmjet zërave korrente brenda të njëjtit program dhe ndërmjet projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program janë bërë me vendim të Kryetarit të Bashkisë, ndërsa ndryshimet ndërmjet zërave të programeve të ndryshme si dhe ndryshimet e ardhura nga rishikimi i buxhetit janë kryer me VKB.

Kështu për vitin 2022 në fund të vitit sipas aktrakordimit me thesarin buxheti është shtuar për vlerën 182,179 mijë lekë pra plani sipas thesarit është për vlerën gjithsej 359,763 mijë lekë në buxhetin e vitit 2022” shtesat vijnë nga transfertat për ndihmë ekonomike dhe paaftësi në vlerën 55,195 mijë lekë, grand shtesë në vlerën 50,000 mijë lekë miratuar me VKB nr. 2, datë 26.01.2022 “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2022”, grand shtesë për vlerën 8,137 mijë lekë miratuar me VKB nr. 49, datë 06.12.2022 “Për likuidimin e detyrimeve të prapambetura”, shtesë për paga ne funksionet e deleguara në vlerën 2,894 mijë lekë, Shtesë fondi për investime të kryera nga fondet e Ministrisë për likuidimin e ujësellsave në vlerën 60,003 mijë lekë, sponsorizim nga Raifaisen në vlerën 2,450 mijë lekë dhe Fond nga këshilli i qarkut në vlerën 3,500 mijë lekë.

Shkalla e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet periodike të monitorimit.

- Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Sarande, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Sarande, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin në fakt është respektuar disiplina buxhetore. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha viti 2022 referuar aktrakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2022			
		Plani fillim viti	Plani thesarit	Fakti	% realizimit
	Paga (600)	71,372	70,621	67,524	96

	Sigurime shoqërore (601)	10,573	10,488	10,453	100
	Shpenzime operative (602)	54,304	69,489	66,700	96
	Transferta (604) F.ondi Rezerv	5,042	6,959	2,454	35
	Fondi Veçantë	3,161	0	0	0
	Inv(230 +231) nga ardhurat e Tr..pakushez	33,128	143,257	116,079	81
	Transferta 606	0	58,949	54,508	92
	Totali	177,584	359,763	317,716	88

Për periudhën objekt auditimi realizimi i buxhetit paraqitet për vitin 2022 nga 359,763 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 317,716 mijë lekë ose në masën 88 %.

Pagat (600) nga 70,621 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 67,524 mijë lekë ose 96%, sigurime shoq. (601) nga 10,488 mijë lekë të planifikuar janë realizuar 10,453 mijë lekë ose 100%, shpenzime operative nga 69,489 mijë lekë janë realizuar 66,700 mijë lekë ose 96%, Fondi rezervë (604) nga 6,959 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 2,454 mijë lekë ose 35% dhe shpenzime për investime (230-231) nga 143,257 të planifikuara janë realizuar 116,079 mijë lekë ose 81%.

Struktura e shpenzimeve sipas planit të thesarit dhe burimeve të financimit paraqiten në tabelën si më poshtë:

N r	Emertimi	Viti 2022							
		Plani fillim viti	Plani thesarit	Fakti	Te ardh veta	Grand	Trans. Kushtez Spec.	Tran. Kusht. Funk Deleg.	Tra. Kush Per Inv.
	Paga (600)	71,372	70,621	67,524	7,000	42,500	19,369	1,752	0
	Sigurime (601)	10,573	10,488	10,453	0	6,920	3,273	295	0
	Shpenzime (602)	54,304	69,489	66,700	29,397	20,044	20,057	0	0
	(604) F. Rezerv	5,042	6,959	2,454	2,000	0	0	0	0
	Fondi Veçantë	3,161	0	0	0	0	2,506	0	2,453
	Inv(230 +231)	33,128	143,257	116,079	25,402	14,701	45,604	0	57,550
	Transferta 606	0	58,949	54,508		2,072	1,613	55,255	0
	Totali	177,584	359,763	317,716	63,799	86,237	92,422	57,302	60,003

Nga të dhënat e pasqyrës sa më sipër konstatohet se shpenzimet buxhetore të vitit 2022, në vlerën 359,763 mijë lekë, sipas burimeve të financimit rezultojnë se nga të ardhurat e veta janë për vlerën 63,799 mijë lekë ose 18%, grandit në vlerën 86,237 mijë lekë ose 24 %, transferta e kushtëzuar specifike 92,422 mijë lekë ose 26 %, transfertat e kushtëzuar e funksioneve të deleguara në vlerën 57,302 mijë lekë ose 16 % dhe transferta e kushtëzuar për investime në vlerën 60,003 mijë lekë ose 16 % e totalit të planit të shpenzimeve.

Shpenzimet për investime për vitin 2022, në vlerën 116,079 lekë i përkasin investimeve të vitit 2022 në vlerën 61,943 mijë lekë dhe 2021 e para në vlerën 54,136 mijë lekë.

-Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.)

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të MFE rubrika “Detyrimet e prapambetura” sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

N.R	Emertimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së

I	Borxhe (a+b)			
a	Hua sftatgjatë			
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër			
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	14,756,764		6.48%
a	Shpenzime korrente	14,756,764		
a,1	Mallra dhe shërbime	14,756,764		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale			
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore			
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	14,756,764	227,584,000	6.48%

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikujduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të vitit ushtrimor rezultoi se:

Për vitin 2022 detyrimet e raportuara janë vlerën 14,756,764 lekë, në PF të vitit 2020 gjendjet e llogarive të klasës 4 të detyrimeve (pasiv bilancit) janë në vlerën **14,756,764** lekë. e cila është e analizuar, si më poshtë:

Nr	Emëri i furnitorit	Fatura	Vlera lekë
1	H.K		58,700
2	O. shpk		30,000
3	K.R		27,500
4	K.	115	950,368
5	T.G.	125	85,000
6	S.H.		160,000
7	F.B.	22	19,650
8	4.K.	268066308	274,140
9	O.		6,395,720
10	E.C.		4,138,000
11	B.L.		1,675,200
12	I.		942,486
	Totali		14,756,764

Raportet e Monitorimit. Për vitin 2022 nuk janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetimit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre. Në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e shqipërisë” neni 65.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42, me Udhëzimin e MFE nr.09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3.

Impakti: Realizim jo të kënaqshëm të shpenzimeve në disa zëra buxheti si dhe realizim jo shumë të mirë të të ardhurave.

Shkaku: Mos programimi i buxhetit mbi bazë prioritetesh dhe nevojash reale dhe ndryshimet e shpeshta e bëjnë të paqëndrueshëm dhe jo efektiv procesin e buxhetimit, ndërsa mos evidentimi i saktë i detyrimeve dhe mos likuidim i tyre sjell rritjen e borxhit që ka Bashkia ndaj të tretëve.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi: Bashkia Konispol, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për periudhen objekt auditimi Bashkia Konispol ka përfiturar fonde nga Ministritë e linjës për realizimin e 2 projekteve të investimeve në infrastrukturë, ujsjellës etj. Kështu:

Për vitin 2022 janë çelur fonde për të paguar shpenzime për investime në shumën 105,607 mijë lekë, për investim ë rrugë dhe ujësjellës.

Projektet e investimit të financiar nga Bashkia Konispol me fondet nga të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar:

Për vitin 2022 janë çelur fonde dhe paguar shpenzime për investime në shumën 40,103 mijë lekë, për projekte investimesh, të prokuruar dhe lidhur kontratat në vitin 2021 e para dhe investimet të vitit 2022.

- **Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022**

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Për vitin 2022 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 4, datë 15.12.2021, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Konispol dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2022”, ku përfshihet edhe strukturën e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas strukturës është e përbërë nga sektorë dhe në total ka 3 punonjës konkretisht 1 Përgjegjës Sektori dhe 2 inspektor për tatim taksa vendore të Bashkisë Konispol. Struktura e të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 është paraqitur në aneksin nr 1 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2022

Bashkia Konispol sipas vendimeve respektive të KB, ka miratuar treguesit e planit të të ardhurave, për vitin 2022 paraqitet në forma tabelore në aneksin nr 2 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Nga analiza e të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se:

Për vitin 2022, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore nga 61,176 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 40,696 mijë lekë ose 67 % me një diferencë në vlerën 20,479 mijë lekë.

Në fakt realizimi i të ardhurave nuk është në këto niveli, pasi në totalin e të ardhurave të arkëtuara janë dhe disa zëra të cilat nuk janë parashikuar në shumën 9,999 mijë lekë.

Kështu realizimi i të ardhurave nëse zbresim vlerat e paparashikuara paraqitet në shumën 30,697 mijë lekë (40,696 mijë – 9,999 mijë), me një realizim në masën 50.2 %, nivel ky shumë i ulët dhe tregon punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në arkëtimin e tyre, ku si rezultat i mos arkëtimeve bën që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2022, të prokurohen pa fonde në dispozicion, duke rritur kështu në fund të periudhave ushtrimore gjendjen e faturave të palikujduara dhe rritur borxhin.

- **Taksa mbi ndërtesa:** Referuar të dhënave të paraqitura në evidencën e kuadruar me Degën e Thesarit Sarandë, rezulton se kjo taksë është realizuar në masën 63%, ku nga vlera e planifikuar prej 4,288 mijë lekë është arkëtuar vlera 2,713 mijë lekë, **një nivel shumë i ulët që ndikon të të ardhurat e bashkisë Konispol.**

- **Taksa mbi tokën bujqësore,** për vitin 2022 është realizuar në masën 57%, ku nga vlera 14,312 mijë lekë është arkëtuar vlera 8,154 mijë lekë ose me mosrealizim në masën 6,157 mijë lekë, **vlerë e cila ndikon në të ardhurat e bashkisë.**

Nga të dhënat e marra në Sektorin e Menaxhimit të Tokave Bashkia Konispol në lidhje me sipërfaqen e tokës gjithsej dhe të ndarë sipas ligjit, paraqitet, si vijon:

Pasqyra.

Nr.	Emri i fshatit	Tok bujq gjithsej/ha	Nga e cila				Familje që kanë marrë tapi	
			Arë	Pemëtor e	Vreshta	Ullishte	Nr.	Ha
1	Konispol	782	423	45	19	135	506	622
2	Çiflig	130	123	4		5	104	132 Ha
3	Vrinë	454	351.5				274	351.5
4	Xarrë	973	500	166			462	666
5	Mursi	797	427	200			450	627
6	Shkallë	238	201	4			123	205
7	Izvor	151	151				150	151
8	Markat	365	195	38	2	5	152	240
9	Ninat	246	112	4		10	99	126
10	Janjar	195	132	1		15	133	148
11	Vërvë	144	104	2.3		1.7	57	108
12	Dishat	119	85	2		1	60	88
13	Shalës	416	224	20		87	228	331
	Totali	5010	3028.5	486.3	21	259.7	2798	3714.5

Burimi: Të dhënat janë nxjerrë nga Sektori i Tokës Bashkia Konispol.

Referuar të dhënave të Sektorit të Menaxhimit të Tokës Bashkia Konispol, por dhe nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se nga sipërfaqja e tokës bujqësore gjithsej **5010 ha**, është ndarë sipas ligjit **3714.5 ha** dhe janë pa ndarë **1295.5 ha**.

Për pjesën e sipërfaqes së pandarë prej **1295 ha**, konstatohet se sipërfaqja prej **693.5 ha**, pronë e Ish- NB Vrinë, nuk administrohet nga Bashkia, por nga Ministria e Bujqësisë për të cilën janë lidhur kontrata qiraje me **12** persona.

Nga ballafaqimet e kryera me punonjësit e bashkisë rezulton se, në territorin e Bashkisë Konispol, nga Ish-Drejtoria e Bujqësisë Rrethi Sarandë, si nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), janë dhënë kontrata qiraje përdorimi të tokës bujqësore, këto kontrata rezultojnë të lidhura në vitin 2000 dhe 2015, të cilat i përkasin:

-10 kontrata të lidhura për një periudhë 30 vjeçare nga Ish-Drejtoria e Bujqësisë Rrethi Sarandë

-2 kontrata të lidhura në vitin 2015 për një periudhë 90 vjeçare nga Ministria e BZHRAU.

Të gjitha këto kontrata nuk disponohen nga Bashkia Konispol, edhe pse nga bashkia u është kërkuar institucioneve një kopje e tyre, me qëllim vlerësimin nëse bashkia Konispol si administratore e territorit në të cilat ndodhen këto sipërfaqe, ka detyrime për vijueshmërinë e zbatimit të tyre apo krijimin e të ardhurave nga përdorimi (nëse janë parashikuar).

-Taksa e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se për aktivitetin e vitit 2022, kjo taksë paraqitet me realizim, pasi nga DPZHT nuk është planifikuar saktë numri i lejeve të ndërtimit të dhënë, ku nga vlera e planifikuar prej 4,340 mijë lekë është arkëtuar vlera 44 mijë lekë.

Titulli gjetjes: Mbi menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Situata: Në auditimin e kryer në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga ASHK, Dega Rajonale Sarandë, u konstatua se.

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2022 – 31.12.2022), kanë paraqitur kërkesë për pajisje me vërtetim mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, gjithsej **7** persona për vlerë takse të llogaritur prej 195,900 lekë, nga e cila deri me datë 31.12.2022 kanë paguar detyrimet 7 persona me vlerë 195,900 lekë. Referuar periudhës përpara vitit 2022 rezulton se gjendja debitorë ngelet e pa ndryshuar. Pra nuk kanë paguar detyrimin **11** persona me vlerë **246,548 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Konispol. Paraqitet sipas aneksit nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Konispol, personat përgjegjës, nuk është bërë asnjë njoftim drejtuar ASHK Dega Sarandë, për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet nëse është marrë ose jo certifikatë pronësie.

Kriteri: Ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, neni 23, pika 2/1 e nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos menaxhim i mirë, veprime në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Konispol në vlerën **246,548 lekë**.

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave drejtuese në zbatimin e ligjit.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi

Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **246,548 lekë** ndaj **11** personave.

-Taksa për hapësirat publike. Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se kjo taksë për vitin 2022 paraqitet me realizim në masën 49%, ku nga vlera e planifikuar prej 260 mijë lekë është

arkëtuar vlera prej 129 mijë lekë, pra më pak për vlerën 185 mijë lekë, si ardhur munguar në buxhet.

Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se kjo taksë paguhet nga 11 subjekte dhe referuar tarifës së përcaktuar me VKB prej 10,000 lekë/vit, kap një detyrim prej 110,000 lekë **ose më shumë se planifikimi prej 150,000 lekë** (260,000 – 110,000) dhe ky i paarkëtueshëm.

-Tarifë pastrimi. Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se kjo tarifë për vitin 2022 paraqitet me realizim në masën 63%, ku nga vlera e planifikuar prej 4,825,000 mijë lekë është arkëtuar vlera prej 3,063 mijë lekë, pra më pak për vlerën 1,761 mijë lekë, si ardhur munguar në buxhet.

Titulli gjetjes: *Puna e pamjaftueshme e agentëve tatimorë në arkëtimin e detyrimeve dhe neglizhenca e strukturave të Bashkisë Konispol në menaxhimin e situatës.*

Situata: Për periudhën objekt auditimi, rezulton se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj me agentët tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Konispol (*brenda datës 5 të çdo muaji*), gjë e cila konstatohet nga fakti se në vitin 2022 nuk ka asnjë arkëtim.

Gjithashtu rakordimi nuk është mbajtur dhe me DRSHTRR Sarandë në lidhje me numrin e mjeteve që ka në përdorim kjo njësi vendore, sa nga këto mjete janë aktiv në gjendje pune, sa nuk janë në gjendje pune, sa paguajnë dhe sa nuk paguajnë dhe nëse derdhjet në buxhet bëhen sipas afateve ose jo.

Të ardhurat e vjela nga agentët tatimorë në Bashkinë Konispol, paraqiten si vijon:

Tabela 1. *Të ardhurat e vjela nga agentët tatimorë në Bashkinë Konispol*

Në 000/lekë

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	Viti 2021		Viti 2022
		Plani	Fakti	Fakti
DRT Sarandë	TFTH	600	438	47
D.R.SH.T Rrugor	Taksa e mjeteve	1,800	1,678	2,363
Z.V.R.P.P (ASHK)	Taks kalim pronësi	0	0	
TOTALI		2,400	2,116	

Burimi: Bashkia Konispol

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë mosrealizimi. Bashkia Konispol nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet.

Për sa më sipër, Bashkia Konispol nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agentët tatimorë, Bashkia Konispol, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura.

Kriteri: Neni 117⁵ të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agentët e mbajtjes së tatimit në burim, agentët e taksave dhe agentët e tarifave”.

⁵ “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifat e mbledhura, apo i shmangët mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së përmbledhura apo të shmangur.”

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkia, nga mos arkëtimin dhe derdhja në buxhet i detyrimeve që arkëtohen nga agjentëve tatimorë.

Shkaku: Neglizhencë e strukturave përgjegjëse në zbatimin e legjislacionit për agjentët tatimor.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi

Sektori i Shërbimeve tatimpaguese Bashkia Konispol, të marrë masa për:

- Evidentimin e diferencave të pambledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura.

- Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifata apo taksat të cilat mbledhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Titulli gjetjes: *Mungesë të ardhurash, nga mos lëshimi i Liçencave/Autorizime të subjekteve që tregtojnë karburante.*

Situata: Gjatë auditimit, u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (*sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas*), në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Në këtë njësi vendore operojnë tre subjekte të tregtimit të karburanteve, *respektivisht:*

4. Subjekti “**L**” ShPK me përfaqësues ligjorë z. *D.K.*, pajisur me autorizim nr. 01, datë 25.6.2020. Sipas të dhënave në dosje, rezulton se nga vlera 1,000,000 lekë është arkëtuar vlera prej 1,000,000 lekë (konferma datë 8.6.2020 dhe 27.07.2020).

5. Subjekti “**H**” ShPK me përfaqësues ligjorë z. *TH.H.*, është pajisur me autorizim nr. 03, datë 7.10.2021. Sipas të dhënave në dosje, rezulton se nga vlera 1,000,000 lekë është arkëtuar vlera prej 500,000 lekë (konferma datë 10.9.2021), **duke mbetur për detyrim shuma prej 500,000 lekë, si mungesë të ardhurash.**

6. Subjekti “**T**” ShPK me përfaqësues ligjorë z. *P.I.* Nga të dhënat e dosjes, rezulton se subjekti ka autorizim nr. 4, datë 10.5.2015 nga ish- Komuna Markat nuk është pajisur me autorizim të ri. Nga Sektori i taksave me shkresën nr. *ekstra*, i është bërë kërkesë për paisje me liçensë tregtimi të karburanteve, por nuk është bërë i mundur arkëtimi i vlerës prej 1,000,000 lekë, **vlerë e cila konsiderohet mungesë të ardhurash në buxhet, si dhe lejimin e ushtrimit të aktivitet pa liçensë.**

Kriteri: VKM nr. 344, datë 19.04.2017 ndryshuar me VKM nr. 970, datë 2.12.2015⁶.

Ndikimi/Efekti: Veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e bashkisë me vlerë 2,000,00 lekë; nenin 77 të ligjit nr. 77, datë 19.5.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, pasi marrëveshje është për detyrimet e palikujduara në fund të periudhave ushtrimore dhe zgjat vetëm një vit kalendarik.

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave në zbatimin e kuadrit ligjorë.

Rëndësia: I lartë

⁶ “9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera”.

Rekomandimi

Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,500,000 lekë** nga 2 subjektet, *respektivisht*;

- **vlera 500,000 lekë** nga subjekti “H” ShPK;

- **vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti “T” ShPK.

Titulli gjetjes: *Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022.*

Situata: Nga informacioni i paraqitur nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol dhe auditimi i tyre, u konstatua se gjendja e debitorëve sipas periudhave objekt auditimi është si vijon:

Emërtimi	Gjendje viti 2021		Gjendje 31.12.2022	
	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë
Nga subjektet fizik	62	3,967,351	47	4,381,593
Nga subjektet juridik	1	38,500	1	404,800
Nga ambientet familjarë	1644	25,896,136	1,601	30,402,805
TOTALI	1707	29,901,987	1649	35,189,198

Burimi: Sektori i Taksave dhe tarifave vendore

Nga të dhënat konstatohet se gjendja e debitorëve më 31.12.2021 është në shumën 29,902,017 lekë kjo për 1707 subjekte/familje, ku debitorët familjarë zënë 86.2% të totalit të debitorëve, gjë e cila tregon se nga Zyra e taksave Konispol nuk punohet në drejtim të arkëtimin të tyre në zbatim të dispozitave ligjore dhe mundësive të gjetjes së rrugëve, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Konispol.

Në krahasim me vitin 2021, gjendja e debitorëve vjen në rritje, ku në fund të vitit 2021 vjen në vlerën 29,901,987 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 35,189,198 lekë **ose me rritje në vlerën 5,287,211 lekë.**

Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, sipas dokumentacionit për arkëtimin e detyrimeve, ka zbatuar vetëm procedurën e njoftimit të subjekteve dhe asnjë procedurë tjetër në zbatim të procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve, **veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhura për Bashkinë Konispol, në vlerën 35,189,198 lekë për vitin 2022.**

Gjithashtu, nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve nuk është vijuar me procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, ku rezultojnë se **48** subjekte debitorë (fizik/juridik) me vlerë **4,786,393 lekë**, janë debitorë në vite.

Kriteri: Në kundërshtim me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*⁷, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), duke u bërë përgjegjës për rritjen e nivelit të borxhit.

Ndikimi/Efekt: Mungesa e të ardhurave në vlerën **35,189,198 lekë**, sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njesisë së Qeverisjes Vendore.

Shkaku: Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifave vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Rëndësia: E lartë

⁷ “Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Për këtë rekomandojmë:

Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **35,189,198 lekë**, si më poshtë vijon:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Sarandë për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Titulli gjetjes: Mbi dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor e kullosor.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga punonjësit e bashkisë për dhënien me qira të pasurive të institucionit të qeverisjes vendore dhe konkretisht kontratat e qirave të lidhura midis Bashkisë Konispol dhe shoqërive private të telefonisë celulare si "V.A" sh.a, dhe të shoqërisë "A" (T. A) sh.a, për periudhën objekt auditimi, në lidhje me mënyrën e lidhjes së kontratave, të përcaktimit të tarifave, të arkëtimit të detyrimeve nga dhënia e objekteve të ndryshme me qira rezulton se nga ana e Bashkisë Konispol dhe ish Komunës Markat sot Njësi Administrative e Bashkisë Konispol, janë lidhur 3 kontrata qiraje të cilat paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

Nr	Emri Shoqërisë	AFATI	Detyrimi vjetor	Paguar	Papaguar viti 2022
1	O.T.	11.6.2020 – 10.6.2022	300,000	300,000	0
2	O.T.	27.3.2021 – 26.3.2022	400,000	400,000	0
3	V.A.	9.2019 – 9.2021-09.2022	800,000	0	800,000
4	V.A.	4.2019 – 6.2021-06-2022	675,000	0	675,000
	Shuma		2,175,000	700,000	1,475,000

Nga të dhënat e pasqyrës, rezulton se jo të gjitha kompanitë kanë likuiduar detyrimet sipas kontratave të lidhura, ku kompania private "V.A" sh.a, nuk janë kryer rregullisht pagesat në masën 100%, duke evidentuar një të **ardhura të munguar në shumën 1,475,000 lekë nga kompania "V.A"**.

Kriteri: Kontrata e qirasë me nr.123 Rep, nr.33/3 Kol, datë 02.02.2015

Shkaku:

Mungesë përgjegjësi e strukturave përgjegjëse në menaxhimin e kontratave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Sektori Shërbimeve Tatimpaguesve Bashkia Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktual të palikujduara nga shoqëria "V.A" në vlerën **1,475,000 lekë**, si e **ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë**.

Për periudhën objekt auditimi dhe shkeljet e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi punonjësit e mëposhtëm:

- z. D.K.me detyrë përgjegjës në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- znj. V.XHme pozicion Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- z. J.H.me pozicion Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2, ku përcaktohet se:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.”

Pika. 3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2022 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2022, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2022
6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit në mbyllje të vitit buxhetor 2022.
8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet,per ditaret,shpenzimet te ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

• ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Konispol” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Sarandë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

• ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Konispol për vitin 2022 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm njësinë shpenzuese Bashkia Konispol pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese.

•

fatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Konispol për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr. 377 prot., datë 30.03.2023 konfirmuar nga dega e thesarit Sarand me shkresën nr. 121 prot., datë 31.03.2023. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Konispol dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

• ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

A

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

• ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

• ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-

daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësishë ekonomike.

• ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2021 është në vlerën 1,825,648,147 lekë dhe për vitin 2022 është 1,886,371,256 lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zberthyer në llogari paraqitet në aneksin nr. 1 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 22,006,117 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 25,493,762 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica ne fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “ Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte” .

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 22,006,117 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 25,493,762 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit dhe me rubrikën analoge “Tepricën e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr.3 “Pasqyrë e flukseve monetare viti 2022” në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, sipas aneksit nr. 2 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,828,836 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,828,836 lekë, e pa ndryshuar, e cila rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”**, paraqitet në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 407,957 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 407,957 lekë, vlerë e cila është e barabarta me vlerën

e dokumentuar në përmbledhësen dhe akt akordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjës material nga përgjegjësi sektorit dhe drejtori financës.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imet”**, paraqitet në të njëjtën vlerë prej 4,420,879 lekë si në mbyllje të bilancit të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022, aktive për të cilat nuk është kryer inventar fizik dhe paraqitet vetëm sipas Inventarit kontabel për vlerën 1,598,199 lekë përse i përket gjendjes së aktiveve të kësaj llogarije në Aparatin e Bashkisë, shkollat e Bashkisë Konispol dhe Ish-Komunës Xarrë, të cilat paraqitet në aneksin nr. 3 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Konkluzion: Sipas tabelës së mësipërme vlera prej **4,420,879 lekë** pjesë e gjendjes së llogarisë 32 “inventar i imet” që i përket ish-Komunës Markat është e pa analizuar dhe për të nuk ka inventar fizik

1. Titulli i Gjetjes: *KLSH konstaton se në gjendjen e llogarisë 32 “Inventari i imet”, e cila paraqitet në të njëjtën vlerë prej 4,420,879 lekë si në mbyllje të bilancit të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022, është përfshirë dhe shuma prej 2,822,680 lekë që i përket inventarit të imet të ish-Komunës Markat, e cila është e pa analizuar dhe për të mungon inventari fizik.*

Situata: *Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imet” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 4,420,879 lekë si në mbyllje të bilancit të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022, aktive për të cilat nuk është kryer inventar fizik, referuar Inventarit kontabel vlera 1,598,199 lekë që i përket gjendjes së aktiveve të kësaj llogarije në Aparatin e Bashkisë në vlerën 976,468 lekë, shkollat e Bashkisë Konispol në vlerën 336,193 lekë dhe NJA Xarrë në vlerën 285,538 lekë. Në gjendjen e llogarisë 32 “Inventari i imet” sipas inventarit kontabel të NJA Markat, e cila paraqitet në një vlerë sintetike prej 2,822,680 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo situatë është trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Konispol i bilancit të vitit 2015 të mbylljes së ish-komunës Konispol i paraqitur me probleme dhe pa analiza për këto aktive.*

Kriteri: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.

Impakti: Paraqitje jo reale e këtyre aktiveve në këtë gjendje llogarije të bilancit, përse i përket aktiveve afatshkurtra të ish-Komunës Markat. Në këto kushte, pasqyrat financiare, nuk japin informacionin e besueshëm mbi ekzistencën ose jo të aktiveve të pasqyruara në këtë llogari

Shkaku: Mosinventarizimi kontabel e fizik i këtyre aktiveve dhe mosanalizimi i këtyre vlerave në bazë të dokumentacionit bazë financiar nga të cilat kanë dalë këto shifra, e në mungesë të tyre mos kryerja e procedurave të vlerësimit të tyre

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: Drejtorisë Ekonomike të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabel të aktiveve të pasqyruara në llog. 32 “Inventari i imet” për shumën 4,420,879 lekë, të bëhet inventarizimi si dhe të nxirren diferencat mes vlerave në kontabilitet dhe vlerave të inventarit fizik, të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore mbështetur në UMF.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 36,477,128 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2022 në vlerën 57,656,164 lekë, ku kemi shtim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i mos kryerjes se pagesave ndaj kreditorëve të ndryshëm në lidhje me investimet dhe shërbimet e ndryshme.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 29,902,017 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 35,189,198 lekë, me rritje për vlerën 5,287,181 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët, sipas akt akordimit midis Sektorit të Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike. Nga analiza e logarisë 468 **“Debitorë të ndryshëm”** konstatohet se Drejtoria e Financës nuk ka bërë kontabilizimin e detyrimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas Vendimit të Kryetarit të dërguara në Bashkinë Konispol edhe pse kan dalë urdhër zhdëmtimeve përkatëse, të dala nga Kryetari i Bashkisë sipas planit të veprimit. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93.

Kriteri:

Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93.

Ndikimi/Efekti:

Mos zbatimi i procedurave ligjore në arkëtimin e detyrimeve, çojnë në mungesë të ardhurash për Bashkinë Konispol

Shkaku:

Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse në Bashkinë Konispol, në zbatimin e akteve ligjore/nënligjore

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Drejtoria e Financë të marrin masa për kontabilizimin e masave shpërblim dëmi të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dërguar në Bashkinë Konispol me shkresat përkatëse.

-**Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta”** (debitorë) më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 22,466,966 lekë. Nga analiza e llogarisë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta”** për vitin 2022 është e analizuar si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2022 e llog 4342
1	Paga Personeli llogaria 42	5,531,627
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	332,680
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	1,621,268
4	Sigurime Shëndetësore llogaria 436	224,627
5	Furnitorëllogaria.401-408	14,756,764
	Shuma	22,466,966

Sa me sipër nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta”** dhe vlerës të pasqyruara në **5 (pesë) llogarive pasive**, pra në vitin 2022 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 5 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivet Afatgjata**” në **aktiv të bilancit** paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I “Investime”). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,718,971,514 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,798,392,494 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,071,648,293 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”**, në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,108,601 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,108,601 lekë. Ndërsa sipas Formatit

7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, paraqitet në mbyllje të vitit 2021 me vlerë 6,108,601 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,108,601 lekë. Sipas Formatit 7/b të PF gjendja e kësaj llogaritje paraqitet në tabelën si më poshtë:

Nr. llog.	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesa gjatë vitit 2021		Gjendja ne fund viti 2022		
		kosto historike 31.12.2021	Amortizimi I akumuluar	Teprica Neto 31.12. 2021	kosto historike	Amortizimi	Kosto historike 2021	Amortizimi I akumuluar	Teprica Neto 2022
	I. TË PA TRUPEZUARA	6,108,601	0	0	0	0	6,108,601	6,108,601	0
201	Prime të emis. e rimb. të huav								
202	Studime dhe kërkime	6,108,601	0	0	0	0	6,108,601	6,108,601	0

Referuar pasqyrës së mësipërme për vlerat e projekteve apo shpenzimeve për mbikëqyrje e studime të përfshira në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” që i përkasin investimeve të kryera në vite të mëparshme dhe që janë kapitalizuar si AQT, duheshin prerë artikuj kontabël për kreditimin e kësaj llogaritje në debi të llogarisë së aktivitetit përkatës sipas vlerave përkatëse për secilin investim, duke ia shtuar vlerën aktivitetit. Ndërsa për vlerat e studimeve e mbetura, të cilat do të mbeteshin gjendje në këtë llogari, duhej përlllogaritur amortizimi për çdo vit në masën 15% në mënyrë lineare deri në amortizimin e plotë të tyre. veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, **pika 36** në të cilin përcaktohet: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon: Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.”.

Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata”** (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm:

a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicioni financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:

- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;

- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (**kosto projektimi**, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.)

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2022.

Titulli i Gjetjes: Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”, mungesa e analizës dhe vlerësimit të tokave, trojeve dhe terreneve të transferuara me VKM, Bashkisë Konispol.

Situata: Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”, paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 24,011,454 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 24,011,454 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2020 dhe vitit 2021 në të njëjtën vlerë prej 24,011,454 lekë. Për këtë vlerë nuk ka analiza dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjithashtu në vlerën e

saj nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar Bashkisë Konispol dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative “Xarrë” dhe “Markat”.

Kriteri: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.

Ndikimi/Efekti: Paraqitje jo reale e këtyre aktiveve në këtë gjendje llogaritje të bilancit. Në këto kushte, pasqyrat financiare, nuk japin informacionin e besueshëm mbi ekzistencën ose jo të aktiveve të pasqyruara në këtë llogari.

Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar nga ish-Komuna Markat.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Titulli gjetjes: *Mbi kontabilizimet në llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 0 lekë gjendje e cila nuk është e analizuar.*

Situata: Gjendja e llogarisë 211 “*Pyje, Plantacione*” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 0 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës këtë llogari ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale

Kriteri: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30

Ndikimi/Efekti: Mungesa e analizës për vlerën 0 lekë që i përket llog. 211 “*Pyje, Plantacione*” ka ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Bashkia Konispol nuk janë marrë masat e nevojshme për regjistrimin, analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite nga Ministritë përkatëse ose çdo ent tjetër shtetëror.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbatimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 383,664,972 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 368,221,963 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 497,239,440 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqiten në aneksin nr. 4 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Titulli i Gjetjes: *KLSH konstatoi se, në gjendjen e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” sipas inventarit kontabël përfshihen dhe aktivet “ndërtesa e konstruksione” të NJA Markat, e cila paraqitet në një vlerë sintetike prej 159,177,745 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo situatë është trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Konispol i bilancit të vitit 2015 të mbylljes së ish-komunës Markat i paraqitur me probleme dhe pa analiza për këto aktive.*

Situata: *Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 383,664,972 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 368,221,963 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 497,239,440 lekë. Për këto AAGJM nuk është kryer inventar fizik. Në gjendjen së llog.212“Ndërtesa” është vlera kontabël e cila është e pa analizuar aktiv për aktiv. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Markat si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë Konispol.*

Kriteri: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.

Impakti: Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe mungesa e analizës për vlerën 159,177,745 lekë me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar nga ish-Komuna Markat.

Rëndësia: *I lartë*

Rekomandimi: Kryetari I Bashkisë Konispol, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbatimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në

vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,264,647,628 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,363,847,293 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **1,453,219,405** lekë. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën **111,839,191** leke, ku janë kryer investime në rrugë, kanale vaditëse, ujësjellës etj. Amortizimi për vitin 2022 është llogaritur 89,372,112 leke. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqiten në aneksin nr. 5 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 29,471,741 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 27,998,154 lekë. Ndërsa në vlerë historike paraqitet në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 41,240,715 lekë e cila është e analizuar sipas vlerës kontabël paraqiten në aneksin nr. 6 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në vlerën neto paraqite në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 13,215,302 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 10,645,295 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 29,321,424 lekë, vlera e amortizimit të akumuluar është 18,676,129 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2021 deri në fund të vitit 2022 paraqiten në aneksin nr. 7 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,960,417 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,668,333 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 20,507,254 lekë. Ndërsa vlera e amortizimit e përlllogaritur është në shumën 16,838,920 lekë.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Në lekë

Nr. referencë Llogarije	Nr. EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund			
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	I. AAGJ/JO MATERIALE	6,108,601	6,108,601	0	0	0	0	0	6,108,601	6,108,601	0
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0					0	0	0
3	202	Studime dhe kerkime	6,108,601	6,108,601						6,108,601	6,108,601	0
4	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme								0	0	0
5	21-26	II. AAGJ/ MATERIALE	1,949,460,261	230,488,747	1,718,971,514	116,079,431	36,658,451	0	0	2,065,539,692	267,147,198	1,798,392,494
6	210	Toka,troje, Terene	24,011,454	0	24,011,454					24,011,454	0	24,011,454
7	211	Pyje,Kullota Plantacione	0	0	0					0	0	0
8	212	Ndertime e Konstruksione	493,499,200	109,834,228	383,664,972	3,740,240	19,183,249			497,239,440	129,017,477	368,221,963
9	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,341,380,214	76,732,587	1,264,647,627	111,839,191	12,639,525			1,453,219,405	89,372,112	1,363,847,293
10	214	Instalime teknike,makineri,pajisje,ve	41,240,715	11,768,974	29,471,741		1,473,587			41,240,715	13,242,561	27,998,154
11	215	Mjete transporti	29,321,424	16,106,122	13,215,302		2,570,007			29,321,424	18,676,129	10,645,295
12	216	Rezerva shtetore	0	0	0		0			0	0	0
13	217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0		0			0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	20,007,254	16,046,837	3,960,417	500,000	792,083			20,507,254	16,838,920	3,668,334
15	24	Aktive te Qend.te trupezuara te den	0	0	0					0	0	0
16	28	Caktime	0	0	0					0	0	0
17		TOTALI (I + II)	1,955,568,862	236,597,348	1,718,971,514	116,079,431	36,658,451	0	0	2,071,648,293	273,255,799	1,798,392,494

Testi substancial i amortizimit

Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”pika 36 Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje te periudhes ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

Për aktivet e llogarive: 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 218 “Inventar Ekonomik”, në të cilat përfshihen paisjet kompjuterike llogaritja e amortizimit është bërë në grup dhe jo aktiv për aktiv dhe nuk mund të verifikoheshin se si janë grupuar dhe llogaritur amortizimi për paisjet kompjuterike.

Vlerat e akumuluarat të amortizimit sipas llogarive dhe veprimeve në kontabilitet paraqiten në tabelën e mësipërme:

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 “Huadhënie e nën huadhënie” dhe 6 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, më 31.12.2021 dhe më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Titulli i gjetjes: Mos kotabilizimi i vlerës monetare 299,600,000 lekë, në llogarinë 26 “Aktive afatgjata financiare” si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Konispol SHA me NUIS “LV”.

Situata Për vitin 2022 rezultoi se: Bashkia Konispol, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2022 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Konispol SHA me NUIS “LV” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 299,600 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 299,600,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalitme 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Konispol në “Ujësjetllës Kanalizime Konispol SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël të vitit 2022, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

Kriteri: Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhrin e MF nr. 64, datë 22.7.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabiliteti të Përimtuar”, me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata jo materiale”, pika 55, 56 dhe 57.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiare viti 2022, të llog 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, çka ka sjell një nënvlerësuar të llog 26 në vlerën 299,600,000 lekë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjetllës Kanalizime Konispol Sh.a me vlerë 299,600,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 94,093,778 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 74,029,195 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 14,756,764 lekë. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga 12 fatura të palikujduara për mallra dhe shërbime të 12 furnitoreve në vlerën 14,756,74 lekë. Ky borxh është krijuar përpara vitit 2015 deri në dhjetor të vitit 2022 sipas bilancit, në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analiza e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”

N/R	EMRI I FURNITORIT	NUMURI		SHUMA
		NIPTI	SERIAL	E
		Q. K. R.	I FATURES	FATURES
1	H.K.			58,700
2	O. sh p k			30,000
3	K.R.			27,500
4	K.	J64228811C	115	950,368
5	T.G.	L87314501M	125	85,000
6	S.H.			160,000
7	F.B.	K64006830F	22	19,650
8	4.K.	L52310028T	268066308	274,140
9	O.E			6,395,720
10	E.C.			4,138,000
11	B.L.			1,675,200
12	I			942,486
				14,756,764

Burimi: Drejtoria e financës.

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 5,531,627 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën kontabël 332,680 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 1,621,268 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2022 është në vlerën kontabël 224,6227 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

-**Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 29,902,017 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 35,189,198 lekë, e cila rakorduar me gjendjen e llogarisë kundërpasit 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit, ku në mbyllje në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 35,189,198 lekë, në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën

14,252,098 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 16,373,031 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Sarandë në mënyrë analitike, e cila paraqitet në aneksin nr. 7 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Titulli gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Situata:

Nga analiza e llogarise 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, konstatohet se Drejtoria e Financës nuk disponon listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje”, nuk jep informacion të plotë, pasi mungon afati i fillimit dhe mbarimit të garancisë së vlerës 5% të punimeve për subjektet private. Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende. Në pasqyrat financiare të vitit 2022 vlera e llogarisë 466 është në vlerën 16,373,031 lekë sipas aneksit nr. 7 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshur, Kap. III, pikat 30, 50.*

Pika 30. “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”,

Pika 50. “Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)”,

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: *UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50.*

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2022 të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”

Shkaku:

Mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, duke rakorduar drejtorinë

njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të paqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2022 paraqitet në aneksin nr. 8 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 222,461,428 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Sarandë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 12,847,644 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 47,237 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 11,216,472 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, ecila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 1,445,470 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 20,427,481 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 5,540,485 lekë, e cila përfshin *taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet*, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 14,886,996 lekë, e cila përfshin *tarifat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj.* Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** në vlerën prej 8,214,966 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” e cila paraqitet në vlerën 22,466,966 lekë, e cila edhe kjo është e pasaktë, pasi gjendja e kësaj llogarije sipas të dhënave të bilancit duhet të ishte në vlerën 22,466,966 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me detyrimeve në pasiv të bilancit janë të sakta dhe reale. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 3.3** “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin” në të cilën përcaktohet se:

Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabël në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi: - Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, “Shpenzime sipas natyrës”; - Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: - Debitohet llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”; - Kreditohet llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”.

c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi: - Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4); - Kreditohet llogaria 520, “Disponibilitete në thesar”.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2022 , të cilat në total janë në vlerën 203,278,535 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 68,468,243 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 68,468,243 lekë diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 10,643,457 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 10,643,457 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 67,205,024 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 67,205,024 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 2,453,596 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 54,508,215 lekë, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

Per vitin 2022 totali i te ardhurave ne vlore është 222,461,428 lekë dhe totali shpenzimeve eshte 213,340,697 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 9,120,731 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatin e ushtrimit”.

B - Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Konispol).

-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Për vitin 2022 numri i punonjësve është miratuar me Urdher nga Kryetari i Bashkisë nr. 01 datë 05.01.2022. Miratuar në total numri 135 + 3 punonjës të Gjendjes Civile = 138 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 128 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Konispol, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara. Sipas listë pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2022 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës z. E.D.dhe nga Specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari Bashkisë; Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjëse i Burimeve Njerëzore z. E.H.dhe nga Nenkryetarja e Bashkisë znj. K.S..

B. 2 - Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2022.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar dhe Dhjetor 2022) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë

prezencave mujore të nënshkuara nga K.S.Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, ”Kodi i Punës”, i ndryshuar. Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Konispol, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Konispol, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar dhe Dhjetor 2022)konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës E.G.nga Specialistet e pagave.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës E.G.dhe nga Kryetari Bashkisë SH.B.

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjëse i Burimeve Njerëzore z. E.H.dhe nga Nenkryetarja e Bashkisë K.S..

Përveç ndalesave të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagë, janë bërë ndalesa edhe për debitorët të përcaktuar në Urdhrat përkatës. (Te vendosura nga Përmbarimi apo palë të tjera.)

Në bazë të urdhrin nr. 762/935, datë 26.12.2019 të Zyres Përmbarimore R.B.S.

Eshte mbajtur vlera 12,000 nga punonjesi cdo muaj.

Paraqitja në formë table e burimit të Financimit.

000/lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transfertë specifike
Viti 2022	70620.53	67523.32	95.6	42500	7000	19368.53	1752

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë 000/lekë

Nr.	Emërtimi	VITI 2022		
		Plani	Fakti	%
1	F. Pagave	70620.53	67523.32	95.6
2	F. Sig. Shoq	10488	10453.29	99.6

***Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.**

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:

Me arkë janë kryer transaksione financiare, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga taksa e tokës bujqësore, taksat e tarifave familjare, për të cilat janë prerë mandate arkëtim të plotësuara me të gjitha ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim e lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, arkëtim gjoba të policisë Bashkiake. Nga arka nuk është kryer asnjë transaksion pagese. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës. Në menyrë të përmbledhur pagesat në arkë për vitin 2022 paraqiten në forëm table si vijon:

JANAR - DHJETOR Nr mandati 01 - 780

NR	MUAJI	DATA + SHUMA	DATA + SHUMA	DATA + SHUMA	DATA + SHUMA	DATA + SHUMA	TOTALI
1.2.3	JANAR	27.01.2022 26.000	27.01.2022 1.648.808	29.01.2022 1.983.506			3,658,314
4.5.6.7	SHKURT	08.02.2022 1.061.240	10.02.2022 841.960	22.02.2022 723.600	28.02.2022 2.527.595		5,154,395
8.9.10.11.12	MARS	09.03.2022 1.339.820	09.03.2022 90.000	18.03.2022 932.540	31.03.2022 3.707.261	31.03.2022 30.700	14,100,321
13.14.15	PRILL	15.04.2022 903.260	29.04.2022 9000	29.04.2022 2.420.383			3,332,643
16.17	MAJ	13.05.2022 383.660	31.05.2022 1.061.585				1,445,245
18	QERSHOR	30.06.2022 1.017.354					1,017,354

19	KORRIK	29.07.2022	667.859				667,859
20.21	GUSHT	10.08.2022	935.380	31.08.2022	1.032.857		1,968,237
22	SHTATOR	29.09.2022	1.123.354				1,123,354
23.24.25.26	TETOR	06.10.2022	1.199.102	07.10.2022	145.122	31.10.2022	2.176.036
27.28	NENTOR	17.11.2022	441.470	30.11.2022	530.779	31.10.2022	45.000
29	DHJETOR	30.12.2022	2.104.207				972,249
							2,104,207
							TOTALI
							39,109,438

Burimi: Bashkia Konispol

Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës konstatohet se të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitin 2022 janë derdhur totalisht në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti është me zero lekë. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje në Bankë në mënyrë periodike dhe arka rezulton me gjendje zero në fund të muajit. Gjithashtu është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, si dhe të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 63,64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit për të ardhurat.

Pika 2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH^{së}, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

Për periudhën objekt auditimi nga subjekti Bashkia Konispol, konstatohet se janë zhvilluar gjithsej 5 procedura prokurime me vlera të larta, ku njëra është anuluar për shkak të tërheqes së OE dhe një procedurë me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Qendër Konispol-Rruga Nacionale” loti I” me fond limit 41,600,000 lekë dhe vlerë kontrate 32,172,320 lekë është audituar sipas Programit të auditimit nr. 257/1, datë 09.03.2022 me fond limit 88,713 mijë lekë të dhënat e të cilive paraqiten në pasqyrën si vijon:

EMËRTIMI	Viti 2022	
	Vlera 000/lekë	Në ndaj fondit %
Fondet prokuruar gjithsej	88,713	
<i>Nga të cilat</i>		
<i>- Në fushën e ndërtimit</i>	72,164	81
<i>-Në fushën e shërbimeve/ blerjeve</i>	16,549	19
Financime nga Bashkia/Grande	29,574	
Financim , Ministri e linjës	59,139	

Rezultatet e auditimit të procedurave përdurha 2022.

Referuar të dhënave për procedurat e zhvilluara për vitin 2022, gjithsej 5 procedura, me fond limit në vlerën 88,713 milë lekë, u audituan 3 procedura pasi një procedurë me objekt “Blerje materjale ndërtimi asfalto-beton” me fond limit 16,548,754 lekë është anuluar pasi është tërhequr OE dhe kjo procedurë është zhvilluar në vitin 2023 dhe një procedurë me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Qendër Konispol-Rruga Nacionale” loti I” me fond limit 41,600,000 lekë dhe vlerë kontrate 32,172,320 lekë është audituar sipas Programit të auditimit nr. 257/1, datë 09.03.2022.

Për procedurat e audituara për vitin 2022, vlera kontratave të lidhura është 25,235 mijë lekë ose 82% e fondit limit të prokuruar.

Konstatohet se numri i operatorëve ne procedurë varion nga 3 deri në 4 shoqëri pjesëmarrëse, gjë e cila tregon interesimin të OE, pavarësisht kritereve që aplikohen nga AK. Kështu për procedurat e audituara kanë marrë pjesë 11 OE/BOE nga e cila janë s'kualifikuar 2 OE/BOE dhe janë kualifikuar 9 OE/BOE.

Nga auditimi ka rezultuar se për vitin 2022, sipas rregjistrimit të realizimit janë zhvilluar 7 procedura prokurimi të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Objekti prokurimit	Fondi limit	Lloji i procedurës	Vlera e kontratës	OE Fitues	Data e lidhjes së kontratës.
1	Blerje materiale ndertimi dhe asfaltim rrugesh rurale ne fshatrat e bashkise konispol	16,548,754	Open Local		Anulluar	
2	Mbrojtje lumore në lumin "pavëll" pranë urës së bogazit	17,539,343	Open Local	14,152,950	M.	11/10/2022
3	Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor, konispol	8,917,090	Open Simple	7,677,777	M.	11/10/2022
4	Rikonstruksion i rrugës "qendër konispol - rruga nacionale", (loti i)	41,600,000	Open Local	3,217,2320	K.	15/4/2022
5	Sigurim jete efektivit zjarrfikës	175,000	Small Value	175,000	A.	
6	Sigurim jete per efektivin e PMNZSh	175,000	Small Value	175,000	A.	
7	Zgjerim i varrezave te fshatit mursi	4,107,687	Open Simple	3,404,550	I.	19/10/2022

Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugës "Qendër Konispol-Rruga Nacionale" loti I" me fond limit 41,600,000 lekë dhe vlerë kontrate 32,172,320 lekë është audituar sipas Programit të auditimit nr. 257/1, datë 09.03.2022.

Procedura e prokurimit me objekt "Blerje materjale ndertimi asfalto-beton" me fond limit 16,548,754 lekë është anuluar pasi është tërhequr OE dhe kjo procedurë është zhvilluar në vitin 2023.

Titulli i gjetjes 2: Aplikimi i kritereve në procedurat e prokurimit, jo në përputhje me aktet ligjore/nënligjore të LPP dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kritereve.

Situata: Nga auditimi i 4 procedurave të prokurimit me fond limit 30,564 mijë lekë, u konstatua se:

a- Në **3 procedura** raste me fond limit 30,564 mijë lekë, pasi kriteret e aplikuar janë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe me tipologjinë e procedurës së zhvilluar, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura.

b- Në **2 procedura** prokurimit, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DST dhe dispozitave të LPP. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurën tjetër me kushte me të favorshme.

c- Në **1 procedur** prokurimit, pas publikimit në APP të njoftimit paraprak të fituesit dhe në pritje së afateve të ankimimit OE është tërhequr nga oferta nëpërmjet një mesazhit në sistemin datë 28.01.2023, konkretisht procedurat:

Nr.	Lloje procedurës	Fondi limit	Fitues	Vl. Kontrate pa TVSh	Shkeljet sipas natyrës
1	Zgjerim i varrezave te fshatit mursi	4,107,687	I.	3,404,550	Kriter
2	Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor, konispol	8,917,090	M.	7,677,777	Kriter/Vlerësim
3	Mbrojtje lumore në lumin "pavëll" pranë urës së bogazit	17,539,343	M.	14,152,950	Kriter/Vlerësim
4	Blerje materiale ndertimi dhe asfaltim rrugesh rurale ne fshatrat e bashkise konispol	16,548,754	Terhequr		Mos konsfikim i sigurimit ofertes
		30,564,120	-	25,235,277	

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

Impakti: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, ka çuar në uljen e numrit të operatorëve pjesëmarrës.

Nga vlerësimi jo i drejtë i operatorëve në garë, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.

Shkaku: Përgjegjësi e anëtarëve të Njësisë së Hartimit të Dokumenteve dhe anëtarëve të KVO, gjatë kohës së zhvillimit të procedurës si në aplikimin e kriterëve jo në përputhje me dispozitat ligjore dhe shpalljen fitues të OE me mangësi në plotësimin e kriterëve.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

- Kryetari i Bashkisë Konispol, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE.

Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

- Kryetari i Bashkisë Konispol, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit.

Procedurat me shkelje në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret sipas DST, për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

1- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Zgjerim i varrezave të fshatit Mursi”, me këto të dhëna:

Zëvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Zgjerim i varrezave të fshatit Mursi.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 2, datë 09.08.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 2, datë 09.08.2022 A.B. M.H. D.K.	4. Komisioni VO nr. 2/1, datë 09.08.2022 L.B. E.D. D.LL.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar”,		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 4,107,687 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) I.ShPK me vlerën e ofertës 3,404,550 lekë pa TVSH.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 82.8 %.
8. Data e hapjes së tenderit 6.9.2022 REF -39641-08-24-2022	9. Burimi Financimit Bashkia Konispol.	10. Operatorë Ekonomike 4: a- Skualifikuar 1 OE b- Kualifikuar 3 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	4. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
4. Lidhja e kontratës Nr. 1131, datë 19.10.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 3,404,550lekë me afat 45 ditë	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me vendim të KB nr. 15, datë 27.04.2022 “Për miratimin e projekt-preventivit të zgjerimit të zgjerimit të varrezave të Mursisë” me vlerë 4,107,687 lekë pa TVSH, me burim financimi të ardhurat e bashkisë Konispol.

Me urdhërin e prokurimit nr. 2, datë 09.08.2022 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 4,107,687 lekë pa TVSH, forma e procedurës e tenderit “E hapur me mjete elektronike” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhërin nr. 2/1, datë 09.08.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 6.9.2022.

Nga NjP është mbajtur PV nr. ska, datë 19.08.2022 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 2, datë 09.08.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 08.09.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithëashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zëvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht:

Pika 2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbaje kategoritë e mëposëtme:

N.S.- 4 A Punime rifiniture të muraturës ...

NS - 18A Punime topogjeodezike

Kategoritë e mësipërme nuk janë të lidhura me tipologjinë e objektit të prokurimit, pasi referuar zërave të preventivit nuk ka punime që përfaqësojnë këto zëra.

N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme

NS – 18/A Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh

Pika 2.3.5.1 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Kokore minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) copë

Jelekë minimumi 15 (Pesëmbëdhjetë) copë

Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 1 (Një) copë

Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pesë) copë

fikse zjarri te lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 (dy) copë;

Kjo kërkesë është e tejkaluar e LPP, pasi nga NJHDT në hartimin e preventivave, të cilat janë bërë pjesë e DT, duhej të zbatonte VKM nr. 664, datë 26.09.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.07, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 05.05.10, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI, “Mbi sigurinë në kantier”, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit. Pjesë përbërëse e këtij 3% janë materialet e kërkuara krahas makinerive e mjeteve.

Pika 2.3.2. Operatori duhet të dëshmojë se ka drejtues teknik që do të angazhohet për realizimin e punimeve.

Aplikimi i këtij kriteri është në kundërshtim me kreun I/2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, ku parashikohet se për punime deri në 30 milionë lekë nuk është detyrim që Drejtuesi teknik të jetë gjatë gjithë kohën në objekt.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: z. A.B. me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit, z. M.H. me detyrë Specialiste Juriste dhe z. D.K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit të Tatimpaguesve.

Zëvillimi procedurës.

Me PV nr. ska, datë 08.09.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë ëapja e procedurës, nga ku konstatoëet se kanë marrë pjesë 5 OE, konkretisht:

1. Shoqëria I.shpk me Nipt JD dhe ofertë 3,404,550 lekë pa TVSH.
2. Shoqëria M.shpk me Nipt JK dhe ofertë 3,750,110 lekë pa TVSH.
3. Shoqëria A.shpk me Nipt KC dhe ofertë 3,900,510 lekë pa TVSH.
4. Shoqëria J.K.shpk me Nipt JM dhe me ofertë 4,079,941 lekë pa TVSH.
5. Shoqëria A.shpk me Nipt JV dhe ofertë 4,104,444 lekë pa TVSH.

Me PV nr. ska, datë 26.09.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë.

Sipas dokumentacionit, KVO nga 5 OE pjesëmarrës ka skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 4 OE. konkretisht:

Nga KVO është skualifikuar Shoqëria A.shpk, pasi puna e ngjashme nuk plotëson kriterin teknik pasi mungon fatura tatimore dhe formulari i vlerësimit.

Në përfundim KVO ka vlerësuar për vendin e parë shoqërinë I.shpk me Nipt JD dhe ofertë 3,404,550 lekë pa TVSH, pasi ka ofertën më të leverdisëme se OE e tjerë në garë.

Me sêkresën nr. ska, datë 14.10.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit. Sëpallur në buletin e APP nr. 117, datë 29.08.2022.

Me sêkresën nr. ska, datë 17.10.2022 është ëartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përsëkruar të gjithë procedurën.

Midis shoqërisë I.Shpk dhe Bashkia Konispol, është ëartuar dhe firmosur kontrata nr. 1131, datë 19.10.2022 për “Zgjerim i varrezave të fsëatit Mursi” me vlerën 3,404,550 lekë pa TVSH dhe me Vlerë 4,085,460 lekë me TVSH., me afat punimesë 45 nga dorëzimi i sësëit të ndërtimit, kjo datë do të konsideroëet si data e fillimit të punimeve.

Vlerësimi i procedurës:

Nga sëqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Shoqëria I.shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK.

2- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugorë, Konispol”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugorë, Konispol.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 3, datë	3. Njësia e Prokurimit nr. 3, datë	4. Komisioni VO nr. 3/1, datë

09.08.2022	09.08.2022	09.08.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar”,	A.B. M.H. D.K.	E.D. D.LL. L.B.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,917,090 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) M.ShPK me vlerën e ofertës 7,677,777 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 86 %.
8. Data e hapjes së tenderit 02.09.2022 REF -39384-08-22-2022	9. Burimi Financimit Bashkia Konispol.	10. Operatorë Ekonomike 3: a- Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 3 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	4. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
4. Lidhja e kontratës Nr. 1092, datë 11.10.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 7,677,777lekë me afat 45 ditë	

Burimi të dhënave: *Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).*

Me vendim të KB nr. 43, datë 22.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022” dhe VKB nr 23, datë 29.06.202 “Për një ndryshim në VKB nr. 43, datë 22.01.2022 është miratuar fondi për prokurimin me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugorë, Konispol” me vlerë 8,917,090 lekë pa TVSh, me të ardhurat e bashkisë Konispol.

Me urdhrin e prokurimit nr. 3, datë 09.08.2022 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 8,917,090 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “E hapur me mjete elektronike” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 3/1, datë 09.08.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 02.09.2022.

Nga NjP është mbajtur PV nr. ska, datë 19.08.2022 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 3, datë 09.08.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 02.09.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuan kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht:

Pika 2.3.2. *Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:*

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-11/ A *Ndërtime per n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e te mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)*

Referuar zërave të preventivit kjo kategori punime nuk është e përshtatshme dhe jo mirëargumentuara, pasi kjo kategori është e përshtatshme për ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe

vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Pika 2.3.3.1 *Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :*

Kokore minimumi 20 (Njëzetë) copë

Jelekë minimumi 20 (Njëzetë) copë

Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 1 (Një) copë

fikse zjarri te lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 (dy) copë;

Kjo kërkesë është e tejkualuar e LPP, pasi nga NJHDT në hartimin e preventivave, të cilat janë bërë pjesë e DT, duhej të zbatonte VKM nr. 664, datë 26.09.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.07, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 05.05.10, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI, “Mbi sigurinë në kantier”, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit. Pjesë përbërëse e këtij 3% janë materialet e kërkuara krahas makinerive e mjeteve.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: z. A.B. me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit, z. M.H. me detyrë Specialiste Juriste dhe z. D.K.me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit të Tatimpaguesve.

Zhvillimi procedurës.

Me PV nr. ska, datë 02.09.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 3 OE, *konkretisht:*

6. *Shoqëria M. shpk me Nipt JK dhe ofertë 7,677,777 lekë pa TVSh.*

7. *Shoqëria A.shpk me Nipt JV dhe me ofertë 8,060,876 lekë.*

8. *Shoqëria A.shpk me Nipt KC dhe ofertë 8,650,365 lekë pa TVSh.*

Me PV nr. ska, datë 27.09.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë.

Sipas dokumentacionit, KVO ka kualifikuar të tre OE, duke klasifikuar në vend të parë shoqërinë *M. shpk me Nipt JK dhe ofertë 7,677,777 lekë pa TVSh, me ofertë më të leverdishme si OE e tjerë.*

Ndërsa 3 OE e tjerë të mbetur në garë janë kualifikuar si të rregullt, duke shpallur fitues shoqërinë *M.me ofertë 7,677,777 lekë pa TVSh, më të leverdishme se dy OE e tjerë.*

Me shkresën nr. ska, datë 08.10.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit. Shpallur në buletin e APP nr. 117, datë 29.08.2022.

Me shkresën nr. ska, datë 10.10.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Midis shoqërisë *M.Shpk* dhe Bashkia Konispol, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 1092, datë 11.10.2022 për “*Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugorë, Konispol*” me vlerën 7,677,777 lekë pa TVSh dhe 9,213,332 lekë me TVSH, me afat punimesh 45 nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

Vlerësimi i procedurës:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria *M.shpk* në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, *konkretisht:*

- Në formularin e vetdeklarimit (shtojca 8) nga subjekti nga 2 Kulle per punime ne rrugica me ngjitje vertikale me kosh, me peshe pune 400 kg e lart, ka paraqitur vetëm një, konkretisht

mjetin me targë AA795KB me kontratë qiraje nr. 3714/649, datë 25.8.2022 me subjektin Agron Karani. Kjo dhe me dokumentacion në dosje është vetëm një mjet.

- Vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike nr. 461, datë 01.09.2022 nuk është i saktë, pasi nuk është në emër të shoqërisë M.por është në emër të individit z. Malo Mane.

- Nga shoqëria nuk është plotësuar pika mbi vërtetimin e taksave lokale, pasi mungon vërtetimi i taksave lokale të Bashkisë Konispol për vitin 2021, pasi kjo shoqëri ka pasur marrëdhënie me bashkinë Konispol me objekt “Urë metalike në Katajeto (Lumi Pavllës), Bashkia Konispol” dhe “Përmisim infrastrukturës së furnizimit me ujë në fshatrat Bashkia Konispol”.

- Nga shoqëria fikse zjarri te lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 (dy) copë, nuk është sipas specifikimeve teknike, pasi referuar faturës nr. 354, datë 14.6.2016 në rreshtin e tretë thuhet thjeshtë fikse zjarri pa asnjë lloj specifikimi sipas DST.

Konkluzioni: Nga sa trajtuar më sipër shoqëria M.shpk nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST. Në këto kushte KVO duhet të vijonte me OE e tjerë në garë për vlerësim, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: E.D. me detyrë Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, D.LL. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit dhe L.B.me detyrë Specialist Inxhinier Ndërtimi.

3- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Mbrojtja lumore në lumin Pavell-pranë urës së Bogazut”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Mbrojtja lumore në lumin Pavell-pranë urës së Bogazut.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 4, datë 09.08.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 4, datë 09.08.2022	4. Komisioni VO nr. 4/1, datë 09.08.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”,	A.B. M.H. D.K.	E.D. D.LL. L.B.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 17,539,343 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) M.ShPK me vlerën e ofertës 14,152,950 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 80.6 %.
8. Data e hapjes së tenderit 19.8.2022 REF -37173-07-26-2022	9. Burimi Financimit Buxheti shtetit.	10. Operatorë Ekonomike 4: a- Skualifikuar 1 OE b- Kualifikuar 3 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	4. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
4. Lidhja e kontratës Nr. 1091, datë 11.10.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 14,152,950lekë me afat 45 ditë	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14216/1, datë 01.08.2022 nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes i janë transferuar fond për fatkeqësi natyrore Bashkisë Konispol në vlerën 21,047,212 lekë për objektin “Mbrojtja lumore në lumin Pavell-pranë urës së Bogazut” Me urdhrin e prokurimit nr. 4, datë 09.08.2022 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 17,539,343 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “E hapur me mjete elektronike” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 4/1, datë 09.08.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 19.8.2022.

Nga NjP është mbajtur PV nr. ska, datë 19.08.2022 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 4, datë 09.08.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 19.8.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Midis shoqërisë M.Shpk dhe Bashkia Konispol, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 1091, datë 11.10.2022 për “Mbrojtja lumore në lumin Pavell-pranë urës së Bogazut” me vlerën 14,152,950 lekë pa TVSh dhe 16,983,540 lekë me TVSH, me afat punimesh 45 nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

- Vlerësimi i kriterëve:

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht:

Pika 2.2.1 OE pjesëmarrës duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore për vitet 2020 dhe 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Pika 2.3.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në :

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, ose

Këto kritere janë në kundërshtim me pikën 5 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Pika 2.3.4. Operatori duhet të dëshmojë se ka drejtues teknik që do të angazhohet për realizimin e punimeve.

Aplikimi i këtij kriteri është në kundërshtim me kreun I/2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, ku parashikohet se për punime deri në 30 milionë lekë nuk është detyrim që Drejtuesi teknik të jetë gjatë gjithë kohën në objekt.

Përveç inxhinierëve në licencën e shoqërisë, operatori ekonomik duhet të ketë në listëpagesat për të paktën 3 muajt e fundit I (një) mjek të përgjithshëm dhe duhet të paraqesë kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë dhe CV, ose këtë shërbim mund ta ketë të siguar me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim. Në këtë rast duhet të paraqesë: kontratë të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë dhe CV.

Nga sa më sipër rezulton se, në Vendimin nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011”, të KM “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, pika 3, gërma “b” dhe pika 4 gërma “b” thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i KM, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, shfuqizohet. Në çdo rast, njësia e prokurimit në vendosjen e këtij kriteri duhet të merrte parasysh faktin se në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 ndër të tjera përcaktohet se:

“shërbimet mjekësore për punëmarrësin, mund të sigurohen jo vetëm me anë të mjekut të punësuar, por edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim”.

Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar. Gjithashtu punësimi i mjekut në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit, rezulton të jetë një kriter i paargumentuar i cili sjell ngushtime të mëtejshme të konkurrencës, duke favorizuar operatorë të caktuar që kanë mjek në listëpagesat

Pika 2.3.6.1 Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

Kokore minimumi 50 (Pesëdhjetë) copë

Jelekë minimumi 50 (Pesëdhjetë) copë

Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 2 (Një) copë

fikse zjarri te lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 (dy) copë;

Kjo kërkesë është e tejkualuar e LPP, pasi nga NJHDT në hartimin e preventivave, të cilat janë bërë pjesë e DT, duhej të zbatonte VKM nr. 664, datë 26.09.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.07, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 05.05.10, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI, “Mbi sigurinë në kantier”, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit. Pjesë përbërëse e këtij 3% janë materialet e kërkuara krahas makinerive e mjeteve.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: z. A.B. me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit, z. M.H. me detyrë Specialiste Juriste dhe z. D.K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit të Tatimpaguesve.

- Zhvillimi procedurës.

Me PV nr. ska, datë 08.9.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 4 OE, konkretisht:

1. *Bashkimi i OE I.A. shpk me ofertë 13,659,660 lekë.*
2. *Shoqëria M.shpk me ofertë ekonomike 14,152,950 lekë.*
3. *Shoqëria J.K.shpk me ofertë 14,898,240lekë.*
4. *Shoqëria A.shpk me ofertë 16,477,650 lekë*

Me PV nr. ska, datë 27.09.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 dhe neneve 82 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021. Në përfundim KVO ka vendosur se nga 4 OE pjesëmarrës është skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 3 OE, konkretisht:

Është skualifikuar bashkimi i OE I.shpk (JD) & A. shpk (J64103808P) me ofertë 13,659,660 lekë, pasi:

- *Vërtetimi mbi likuidimin e detyrimeve të energjisë elektrike per operatorin A. sh.p.k mban datën 07.09.2022 dhe nuk përfshin muajin Korrik 2022 edhe pse është maturuara për pagesë.*
- *Operatori ekonomik I. në marrëveshjen e bashkëpunimit ka marrë përsipër punime që përfshihen në kategorinë e licensës NP – 9 A, ndërkohe ne licensën me nr NZ 0361/12 nuk e përmban këtë pikë.*
- *Puna e paraqitur nga operatori I. “Rikonstrukcion i rrugëve të brendshme të qytetit Delvinë” nuk përbën punë të ngjashme pasi nuk ka asnjë zë që përkon me pikën NP – 9 A të licensës (punime dhe mbrojtje lumore)*
- *Operatori I.ka marrë përsipër 32% të zërit “Blloqe betoni te parapërgatitur C16/20”, ndërkohë në shtojcën nr 8 nuk ka të deklaruar pronësi për linjë prodhim betoni/kontratë qera/ apo furnizimi për*

pjesën që do të realizojë.(në rastin kur operatori I.do të marrë përsipër vetëm prodhimin e kallëpit dhe punimin e betonit, atëherë sipas manualit të çmimeve të miratuar në vitin 2015 kjo kalon sasinë prej 32% të vlerës së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit)
-Operatori I.ka marrë përsipër zërin “Betonim brez beton arme C16/20 me sasi 90 m3 ndërkohë në shtojcën nr 8 nuk ka të deklaruar pronësi /kontratë qeraje/ apo furnizimi për linjë prodhim betoni për pjesën që do të realizojë.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi skualifikimin e shoqërisë, konstatohet se ai është vlerësuar drejt nga KVO.

Ndërsa 3 OE e tjerë të mbetur në garë janë kualifikuar si të rregullt, duke shpallur fitues shoqërinë M.me ofertë 14,152,950 lekë pa TVSh, më të leverdishme se dy OE e tjerë.

Me shkresën nr. ska, datë 8.10.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit. Shpallur në buletin e APP nr. 117, datë 29.08.2022.

Me shkresën nr. ska, datë 10.10.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria M.shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

- Në formularin e vetdeklarimit (shtojca 8) nga subjekti nuk është paraqitur një shofer. Gjithashtu kamionët e paraqitur nuk janë sipas specifikimeve teknike deri në 20 ton dhe deri në 10 tonë, por paraqiten me kapacitet mbi 24 ton.

- Vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike nr. 461, datë 01.09.2022 nuk është i saktë, pasi nuk është në emër të shoqërisë M.por është në emër të individit z. Malo Mane.

- Nga shoqëria nuk është plotësuar pika mbi vërtetimin e taksave lokale, pasi mungon vërtetimi i taksave lokale të Bashkisë Konispol për vitin 2021, pasi kjo shoqëri ka pasur marrëdhënie me bashkinë Konispol me objekt “Urë metalike në Katajeto (Lumi Pavllës), Bashkia Konispol” dhe “Përmisim infrastrukturës së furnizimit me ujë në fshatrat Bashkia Konispol”.

- Nga shoqëria nuk plotësohet kriteri i punime të ngjashme, pasi kontrata e paraqitur nr. 788, datë 10.05.2021 të lidhur midis shoqërisë M.dhe bashkisë Dropull dhe Gjirokastër me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në fshatrat e bashkisë dhe mbrojtje malore” me verë kontrate 15,857,160 leke me TVSh.

- Nga të dhënat e preventivit vetëm rubrika e parë me vlerë 3,117,500 lekë është punime i ngjashëm, pasi rubrikat e tjera nuk janë punime të ngjashme. Kjo vlerë nuk është 30% e fondit limit që kërkohet në DST, pasi fondi limit është **5,261,802.9 lekë** pa TVSh (17,539,343 x 30%), vlerë e cila është më e madhe se vlera e kontratës së ngjashme. Për të njëjtën mangësi është skualifikuar OE me ofertë më të leverdishme.

Konkluzioni: Nga sa trajtuar më sipër shoqëria M.shpk nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST. Në këto kushte KVO ose midis OE me mangësi duhet të vlerësonte kriterin kryesorë të çmimit të leverdishëm ose të vijonte me OE e tjerë në garë për vlerësim, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: E.D. me detyrë Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, D.LL. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit dhe L.B.me detyrë Specialist Inxhinier Ndërtimi.**

4-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale ndërtimi dhe asfaltim rrugësh rurale në fshatrave të Bashkisë Konispol”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje materiale ndërtimi dhe asfaltim rrugësh rurale në fshatrave të Bashkisë Konispol.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 5, datë 25.11.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 5, datë 25.11.2022	4. Komisioni VO nr. 5/1, datë 25.11.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”,	A.B. M.H. D.K.	E.D. D.LL. L.B.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 16,548,754 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) “JD” ShPK me vlerën e ofertës 7,677,777 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 86 %.
8. Data e hapjes së tenderit 06.01.2023 REF -39384-08-22-2022	9. Burimi Financimit Bashkia Konispol.	10. Operatorë Ekonomike 2: a- Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 2 OE:
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	4. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
4. Lidhja e kontratës Nr. anuluar	15. Vlera e kontratës (me TVSh) anuluar	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Nga NjP është mbajtur PV nr. ska, datë 12.12.2022 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrit të prokurimit 5, datë 25.11.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 06.01.2023), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- Vlerësimi i kriterëve:

Në auditimin e kriterëve të vendosura nuk janë konstatuar kriteret në kundërshtim me zhvillimin e procedurës dhe zbatim të neneve 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Zhvillimi procedurës.

Me PV nr. 06.01.2023, datë 25.8.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

-Shoqëria “JD” shpk me ofertë 13,834,205 lekë pa TVSh.

-Shoqëria K.shpk me ofertë 15,618,450 lekë pa TVSh.

Me PV datë 16.01.2023 nga KVO është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, ku në fund KVO ka vendosur kualifikimin e të dy OE, duke shpallur fitues shoqërinë “JD” shpk me ofertë 13,834,205 lekë pa TVSh me ofertë më leverdishme.

Me datë 18.01.2023 është bërë njoftim klasifikimi dhe ngarkuar në sistemin njoftimi i fituesit në zbatim të nenit 32, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021.

Pas publikimit në APP të njoftimit paraprak të fituesit dhe në pritje së afateve të ankimimit OE “JD” shpk është tërhequr nga oferta nëpërmjet një mesazhit në sistemin datë 28.01.2023.

Titulli i gjetjes 4: Mos konfiskimin e sigurimit të ofertës.

Situata:

Sipas PV vlerësimit të hartuar nga KVO, thuhet se OE “**JD**” shpk është tërhequr nga oferta nëpërmjet një mesazhit në sistemin datë 28.01.2023.

Nga Bashkia Konispol (Sektori i prokurimeve dhe financës), nuk është vepruar për konfiskimin e sigurimit të ofertës me vlerë **276,684 lekë**.

Kriteri:

Në zbatim të nenit 83, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ndikimi/Efektiviteti:

Nga verifikimi i të dhënave në Drejtorinë Ekonomike, konstatohet se ky konfiskim nuk është zbatuar, **veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e bashkisë për shumën 276,684 lekë, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi E.G.me detyrë Drejtor Finance dhe z. A.B. me detyrë Drejtor i PZHT, në cilësinë e administratorit të procedurës.**

Pika 2. 5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Këshilli Kombëtar i Territorit në përputhje me ligjin nr. 107/2017, datë 31.07.2014 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Bashkia Konispol me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr.27, datë 16.08.2017, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT-së) nr. 4 datë 16.10.2017. Ky Plan mbulon Territorin e Bashkisë Konispol me sipërfaqe 22,303.86 ha, ku përfshihen pesë Njësi Administrative. Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë së bashku me tarifata që aplikohen në aplikimet që kryhen në sistemin e-leje, janë të përcaktuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, në paketën fiskale vjetore, përkatësisht: VKB Nr. 41 datë 15/12/2021 për vitin 2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë.

1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për leje zhvillimore ndërtimi në pronë private dhe publike;

Zyra e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Konispol ka ushtruar funksionet dhe detyrat e saj bazuar në ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015”.

Bazuar në sa më sipër, gjatë vitit 2022 është miratuar 1 Vendime për Leje Ndërtimi, është miratuar një leje infrastrukturore si dhe janë miratuar 2 deklarata paraprake të cilat janë paraqitur në tabelën nr.1 si sijon:

Lejet e ndërtimit të miratuara për vitin 2022, sipas klasifikimit dhe llojit të lejes, si vijon:

Nr.	Emërtimi i objektit për Gjashte mujori i pare viti 2021	L/N	L/ZH	Ç/P
1.	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2			
1.1	Magazina bujqësore të ndryshme	1	3	
	Totali	1	3	
2.	Leje Infrastrukturore			
2.1	Argjinaturë/Bashkia	1	-	
	Totali	1		
3	Deklaratë Paraprake			
	Rikonstruksion i varrezave	1		
	Mirmbajtje rrugve	1		
	Totali	2		
	TOTALI (1-3)	5	3	

Nga auditimi u konstatua se, gjatë viteve 2022 në Bashkinë Konispol nuk është miratuar Leje Ndërtimi për subjekte private në pronë shtetërore. Të gjitha Lejet e miratuara kanë qënë në truall privat të personave apo subjekteve që kanë aplikuar dhe janë pajisur me leje ndërtimi.

2. Auditimi i Lejeve Infrastrukturore

Nga auditimi i Lejeve Infrastrukturore rezultoi se për periudhën objekt auditimi është dhënë 1 leje është Zhvillues Bashkia Konispol, si vijon:

Nr.	Nr. protokolli	Zhvilluesi	Objekti	Vendimi I Miratimit	
				Nr	Datë
1	273	Bashkia Konispol	“rikonstruksion i rruges “qender konispol - rruga nacionale”, (loti i)	273/1	21.04.2022

Leje të ndërtimit për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 për vitin 2022

Nga dokumentacioni i sipër cituar rezulton se për periudhën objekt auditimi Janar 2022 – dhjetor 2022 është miratuar gjithsej 1 leje e ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se >250 m2. Në mënyrë të detajuar paraqiten lejet si vijon:

VITI 2022

Objekti: “Magazine për grumbullim dhe ruajtje produktesh bujqësore - 1 kat.

Leje Zhvillimi: Vendim Nr. 462/1, datë 10/05/2022 i Kryetarit të Bashkisë Konispol me zhvillues ““F” nr. pasurie 3749/10, ZK 2747, në pronësi të “KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË”, marrë me qira për 27 vjetë nga shoqëria “F” sipas kontratës me datë 26/05/2021, Rep.4573, Kol.1381, me kufij (V/J/L/P), sipërfaqe 3000 m2 dhe adresë Mursi

Leje ndërtimi : Vendim Nr. 643/2, datë 21/06/2022 të Kryetarit të Bashkisë Konispol

Me zhvillues: “A”

Të dhëna për pasurinë:

Pasurinë me nr. pasurie 3749/10, ZK 2747, në pronësi të “KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË”, marrë me qira për 27 vjet nga shoqëria “F” sipas kontratës me datë 26/05/2021, Rep.4573, Kol.1381, me kufij (V/J/L/P), sipërfaqe 3000 m2 dhe adresë Mursi.

Afati kohor i kësaj leje është: 12 muaj Pronat që zhvillohen Pasuria Nr 3749/10 dhe ZK 2747 Treguesit Sipërfaqe e përgjithshme e truallit: 3000 Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (gjurma): 317.9 Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit total: 317.9 Koeficienti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim: 10.5 % Intensiteti i ndërtimit: 0.10 Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemit: 7.7 Numri i kateve mbi tokë: 1 Numri i kateve nën tokë: 0

Sa më sipër miratimi i lejes së ndërtimit është në përputhje me ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015”.

Pika 6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).

Situata: Struktura e Inspektoratit së Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Konispol (IMTV) për vitin 2022 është miratuar me VKB “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Konispol dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara”, ku përfshihet Inspektoratit së Mbrojtjes së Territorit Vendor e cila përbehet nga 2 punonjës në pozicionin e inspektorit.

Nr	Emer	Mbiemer	Arsimi	Arsimi kerkuar per pozicionin e punes	Detyra/funksioni	Data e fillimit
1.	E	Z	I mesem		Inspektor	01.09.2017
2.	A	K	I mesem		Inspektor	02.09.2021

Nga të dhënat e marra nga administrata e Bashkisë Konispol, Struktura e IMTV për këtë Bashki nuk është plotësuar me pozicionin e Kryeinspektorit, në kundërshtim me nenin 4 të ligjit Nr.9780, datë 16.7.2007 për Inspektimin në Ndërtim. Nga po këto të dhëna konstatohet se dy inspektorët e Inspektoriatit janë me arsim të mesëm në kundërshtim me nenin 11 të ligjit Nr. 9870, datë 16.07.2007

1.4.Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njësive të vartësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre.

Në lidhje me auditimin e kryer të dokumenteve të vëna në dispozicion nga zyra e IMTV, për ushtrimin e kontrollit në terren të kontrollit mbi territorin e Bashkisë, nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Konispol për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022 rezultoi se është mbajtur vetëm një procesverbal nr, 11 dt. 26.10.2022, me kundërvajtje administrative “Shkelje afati të fillimit të punimeve në zbatim të nenit 12, të ligjit Nr. 9780, Datë 16.07.2007“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, për të cilat kanë vijuar procedurat e mëtejshme ligjore, sipas nenit 13, të ligjit Nr. 9780, Datë 16.07.2007. Në mbarim të procedurave të parashikuara nga ligji subjekti u dënua me gjobë në vlerën 100.000 lekë. Gjoha eshte paguar nga subjekti A. H. me nr. faturë 11 dt 28.10.2022.

Në lidhje me realizimin e të ardhurat nga gjobat e vendosura nga Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë (IMTV) konstatohet se:

Nuk ka pasur vendime pezullime, vendime prishje apo kallëzime penale. Nga pyetëtori drejtuar Bashkisë Konispol, u konstatua se përgjatë vitit 2022 ka pasur veprimtari të ulët ndërtimore.

Nga auditimi rezultoi se Sektori i IMT, Bashkia Konispol për periudhën 01.01.2022 deri me 31.12.2022 **nuk ka një plan pune vjetor** ose mujor.

Kriteret: Ligji Nr. 9870, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin në Ndërtim” neni 4 dhe 11

Shkaku: Mungesa e burimeve njerëzore të specializuar për plotësimin e vakancave në Strukturën e IMTV

Ndikimi: Cënimi i veprimtarisë ligjore të strukturës së IMTV për shkak të vakancave në strukturën e IMTV dhe mungesës së kualifikimit arsimor të punonjësve që janë pjesë e kësaj strukture.

Rëndësia: E lartë:

Rekomandimi: Të plotësohet vakanca në strukturën e IMTV, konkretisht pozicioni i Kryeinspektorit në përputhje me përcaktimet ligjore të Ligjit Nr. 9870, datë 16.07.2007.

Pika .7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Konispol rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 257/6 prot, datë 31.05.2022, ndërsa nga Bashkia Konispol për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 673/1 Prot. datë 14.06.2022. Pra përgjigja e Bashkisë Konispol për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë **brenda 20 ditësh**, brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Konispol është urdhëruar hartimi i Planit të Veprimit

Urdhër nr. 31 datë 13.06.2022, si dhe krijimi i grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve me shkresë nr. 699/1 prot, 15.06.2022.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Konispol, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 257/6 prot, datë 31.05.2022,dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve.

Nga ana e Bashkisë Konispol nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, *ku përcaktohet se*: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna dhe ngarkon me përgjegjësi Nëpunësin Autorizues.

Pa zbatuar

3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, rezulton se:

Rregullorja e Brendshme nuk është plotësisht në përshtatje me strukturën organike aktuale, pasi mungojnë përcaktimet e detyrave dhe përgjegjësi të Sektorit të Menaxhimit të Aseteve. Kështu në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Blegtorisë është shtuar pozicioni “*Inspektor për mbrojtjen e konsumatorit*” dhe në Drejtorinë Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit, janë shtuar pozicionet “*Specialist inxhinier hidroteknik*” dhe “*Sekretar i sekretarisë teknike*”, pozicione të cilat mungojnë në rregullore.

Nuk janë përfshirë rastet e konfliktit të interesit, si dhe nuk janë përcaktuar procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsisive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive.

Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të Brendshëm. Nga 3 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

“Menaxhimi i Riskut”

- Nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut.

- Mungon urdhri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut.

- Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.

- Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut.

- Nuk janë hartuar planet e veprimit për menaxhimin e riskut

- Nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.
- Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Mungon sistemi i “IT” dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (BACK-UP)
- Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar “IT” të ndryshme në sektorë të ndryshëm, si dhe nuk ka plan investimesh për programet e “IT”. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit, nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakt dhe produkti.
- Rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës, veprime në kundërshtim me ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8 pika 8 shkronja (d, e), Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, në cilësinë e Kryetarit të GMS dhe të Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit të Riskut, *të marrë masa për:*

- Hartimin e Rregullores së re, e cila të jetë në përshtatje me strukturën organike të miratuar për vitin 2021, duke përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë për pozicionet e reja, si pjesë e organigramës aktuale dhe përcaktimin e linjave të raportimit. Të përcaktohen rastet për parandalimin e konfliktit të interesit dhe procedurat e antikorrupsion.
- Hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.
- Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë e programeve, realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakt, si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi:

1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Me urdhërin nr. 17 datë 12.01.2022 është ngritur grupi i menaxhimit Strategjik dhe ekipeve të Menaxhimit të Programeve Buxhetore

Më vendimin nr. 1 datë 05.01.2022 është hartuar rregullorja e re e institucionit ku janë parashikuar të gjitha pozicionet e punës sipas strukturës organizative të institucionit. Janë përcaktuar përshkrimet e pozicioneve të punës si dhe linjat e raportimit. Gjithashtu janë përcaktuar planet për vlerësimin e riskut, mashtrimin, procedurat e sinjalizimit, rastet e korrupsionit, konfliktit të interesave dhe hetimit administrativë etj.

Zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hartimin dhe funksionimin e strukturës organike të Bashkisë Konispol, nuk gjejmë të pasqyruar strukturën e Auditit të Brendshëm (AB), kjo për mungesë të specialistëve dhe nuk ka lidhur as aktmarrëveshje me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja (c), si dhe nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, te VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6 shkronja (a) (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2, faqe 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Konispol, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Sarandë ose Dropull.

Menjëherë

2.1.1 .Nga verifikimi rezultoi se: *Problematikat e hasura kanë të bëjnë me mungesën e burimeve njerëzore të secializuara që përmbushin kriteret e nevojshme sipas procedurave te rekrutimit. Institucioni është në komunikim me njësi të tjera vendore kufitare për të lidhur marrveshje për mbulimin e ketijë funksioni por vërehet se vetëm një njësi vendore ka strukturë të ngritur.*

Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Konispol dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB, ku për vitin 2021 kanë ndodhur 3 ndryshime, veprime që tregojnë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

-Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve nuk është bërë përcaktimi në vlerë dhe detajimi për çdo program i detyrimeve të papaguara të vitit paraardhës, ku për vitin 2020 paraqiten në shumën **13,578 mijë lekë** dhe për vitin 2021 në shumën **43,364 mijë lekë**.

- Realizimi i buxheteve për vitin 2021 nga 296,365 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 268,833 mijë lekë ose në masën 90%. Peshën specifike më të madhe në buxhet e kanë shpenzimet për investime të cilat zënë 27.87%.

- Të ardhurat për vitin 2021 janë realizuar në masën 77%. Ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore, paraqitet në nivele të larta, përkatësisht në shumën **29,902 mijë lekë**.

- Për vitin 2021, nga Bashkia Konispol, nuk janë përgatitur raporte 4-mujore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe krahasimi i tyre me planifikimin e buxhetit për çdo zë të tij sipas programeve të hartuara në bazë të funksioneve të kësaj njësie vendore për tu paraqitur në Këshillin e Bashkisë, duke mos evidentuar në ç’masë janë arritur objektivat, shkaqet e mosrealizimeve të zërave të shpenzimeve dhe të ardhurave, me qëllim përmirësimin e

planifikimit të kërkesave të programit në periudhat e ardhshme si dhe përcaktimin e masave që duhet të merren për përdorimin e fondeve me efektivitet.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48, me UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar pikat 253,354, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” pikat 82-91 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhetit Bashkia Konispol, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

3.1.1.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar shkresës nr. 17 datë 12.01.2022 ka dalë urdhri i titullarit nr. 4 datë 12.01.2021 “Për ngritjen GMS dhe ekipeve të menaxhimit të programeve”. Në këtë urdhër është ngritur GMS me 7 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë (NA) dhe 4 ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA 2022-2024.

Zbatuar

3.2 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhetit Bashkia Konispol, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, duke respektuar dhe radhën e pagesave.

3.2.1.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar bilancit kontabël dërguar Drejtorisë së Thesarit Sarandë me shkresën nr. 377 prot datë 30.03.2023 vlera e detyrimeve të prapambetura paraqitet në vlerën 14,756 mijë lekë pra me një ulje në vlerën 28,608 mijë lekë.

Në proces zbatimi

3.3 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhetit Bashkia Konispol, të marra masa për përgatitjen e raporteve periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe krahas tyre për uljen e detyrimeve në mënyrë të kontrolluar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen në fund të vitit 2021 të faturave të pa likuiduara të prapambetura në vlerën reale 43,364 mijë lekë, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

3.3.1.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar bilancit kontabël dërguar Drejtorisë së Thesarit Sarandë me shkresën nr. 377 prot datë 30.03.2023 vlera e detyrimeve të prapambetura paraqitet në vlerën 14,756 mijë lekë pra me një ulje në vlerën 28,608 mijë lekë. Është raportuar periodikisht cdo 4 mujor ne menyre elektronike.

Zbatuar pjesërisht

4. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit të KLSH-së, konstatohet se niveli i realizmit të shpenzimeve/ dhe investimeve të planifikuara për vitin 2021 paraqitet në masën 37 %, ku nga vlera planifikuar prej 45,494 mijë lekë është realizuar vlera prej 28,355 mijë lekë ose në masën 37%.

Sipas Grupit të KLSH, kjo vjen nga planifikim i procedurave pa fonde në dispozicion që në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje mali), në raport me nivelin e planifikimit të të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre, nivel ky i cili nuk kalon limitet e 77% për asnjërin nga vitet objekt auditimi.

Bashkia Konispol për vitin buxhetor 2021, ka planifikuar të ardhurat e veta **në vlera jo reale dhe të pa argumentuara**, pasi ka një rritje artificiale të planit të të ardhurave fenomen që vihet re edhe nga realizmi i tyre **në nivele jo të mira**.

Nisur nga ky fenomen gjatë planifikimit të buxhetit vjetor 2021, Bashkia Konispol ka planifikuar të kryejë shpenzime kapitale dhe korrente bazuar mbi transfertës e pakushtëzuar dhe planit të të ardhurave jo real. Për rrjedhojë konstatohet një përqindje shumë e ulët e realizimit të investimeve/ dhe shpenzimeve të planifikuar, pasi fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit (transf.e pakushtëzuar), përdoret kryesisht për mbulimin e fondit të pagave dhe sigurimeve në masën rreth 97.3%.

Për sa më sipër nisur edhe nga fakti i realizimit të ulët të të ardhurave si dhe nga stoku i detyrimeve aktual në shumën **43,364 mijë lekë**, projeksioni mbi vitet pasardhëse 2022 për shpenzimet që duhet të kryejë për kontratat kryesore me burim financimi të ardhurat e veta është në shumën **22,504 mijë lekë**, për rrjedhojë do të çojë në vështirësi financiare dhe pa aftësi paguese të kontratave të lidhura në vitin 2021.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet Bashkia Konispol, të marrë masa që planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbim dhe investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Konispol.

Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

4.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Me vendim të Këshillit Bashkiakë nr. 41 datë 15.12.2021 është miratuar niveli i takave dhe tarifave në Bashkinë Konispol konfirmuar nga prefekti i qarkut Vlorë me shkresën nr. 984/1 prot datë 27.12.2021, mbi të cilën është bërë dhe planifikimi i të ardhurave i cili është miratuar në buxhetin faktik 2022.

Zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave dhe testet e kryera për vitin 2021, rezulton se janë kryer pagesa mbi afatin **30 ditore** të faturave për shpenzime/ shërbime/investime të mbërritura në institucion, gjithsej **4** fatura me vlerë **1,199,500** lekë. Ky fenomen vjen nga mosrealizim i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore.

Gjithashtu, në Bashkinë Konispol evidentohen dhe raste ku fatura nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre kjo për efekt të mungesës së fondeve nga realizimi i të ardhurave vendore, gjithsej **3** fatura me vlerë **9,014,990** lekë.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48; Ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Financë Buxhet Bashkia Konispol, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijohet kufizime limiti të arkës (përrjashtuar kufizimet e transferta specifike nga Ministrinë e Linjës dhe donator të ndryshëm), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikujduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

5.1.1.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar postës bankare konstatohet se bashkia Konispol nuk ka respektuar radhën e kryerjes së pagesave. Më gjerësisht trajtuar në Akt konstatimin e pasqyrave financiare.

Pa zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, rezulton se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj me Agjentët Tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja Drejtoria Rajonale Sarandë, nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Konispol (*brenda datës 5 të çdo muaji*), gjë e cila konstatohet nga fakti se në vitin 2021 nuk ka asnjë arkëtim.

Gjithashtu rakordim nuk janë mbajtur dhe me DRSHTRR Sarandë në lidhje me numrin e mjeteve që ka në përdorim kjo njësi vendore, sa nga këto mjete janë aktiv në gjendje pune, sa nuk janë në gjendje pune, sa paguajnë dhe sa nuk paguajnë dhe nëse derdhjet në buxhet bëhen sipas afateve ose jo.

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë mosrealizimi.

Bashkia Konispol nga ana e sajë nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet.

Për sa më sipër, Bashkia Konispol nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, nga Bashkia Konispol nuk janë marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjorbitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura.

Veprimet e mësipërme kanë në kundërshtim me nenin 117 të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 33-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve tatimpaguese Bashkia Konispol, të marrë masa për:

- Evidentimin e diferencave të pambledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura.

- Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Sektori i taksave Bashkia Konispol është në proces të krijimit të bazës së të dhënave të cilat mblidhen nga agjentët aktualisht janë mbajtur akt rakordime si vijon:

AgjentiTatimor	Lloji I Taksës	2021	31.12.2022
D.R.T.SHRrugor	Taksa e mjeteve	1.678.000	2.363.781
Z.V.R.P.P (ASHK)	Taksekalimpronesi	0	0
DRT Sarande	TFTH	438.000	47.237

Ne proces, zyra e taksave dhe zyra e finances kane diskutuar te krijojne bazen e te dhenave per subjektet tarifatat apo taksat te cilat mblidhen nga agjentet tatimore pasi kjo eshte ne ndihme te te ardhurave.

Në proces zbatimi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi menaxhimin e aseteve nga Bashkia Konispol, rezulton se:

- Nuk është vepruar për marrjen në dorëzim të aseteve të qëndrueshme me komision dhe me procesverbal të nënshkruar nga përfituesi Bashkia Konispol dhe nga institucionet qendrore si dorëzues të aseteve, institucione këto, në pronësi të të cilave kanë qenë pronat dhe asetet, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës, arsim, shëndetësi, kulturë, sport, monumente historike e kulturore, shërbime publike, infrastrukturë, bujqësi e ushqim, ujësjellës, troje dhe hapësira publike, pyje kullota, për të cilat do të duhej të ishin shoqëruar me harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre, etj.

-Nuk ka kryer kolaudimin dhe vlerësimin e aseteve, si dhe nuk është kryer inventarizimin kontabël dhe fizik të aseteve;

- Nuk ka aplikuar në ASHK Dega Sarandë për regjistrimin e aseteve, si dhe nuk ka hartuar përmbledhjen dhe bashkimin e listave të aseteve të dy Njësive Administrative ish-komunat, Markat dhe Xarrë, për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin në pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Konispol.

- Nuk është dërguar informacion me shkrim, për zyrën e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Vlorë, në lidhje me dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, në dhjetor të çdo viti.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”; VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”; pika 66 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30,35/a; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1 dhe UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu V, pika 4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 33-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa dhe të krijojë komisionin për marrjen në dorëzim të aseteve jo nën administrim, duke hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim të pronave, i cili duhet të nënshkruhet nga dorëzuesi i pronës dhe përfituesi (Bashkia Konispol), si dhe duhet të shoqërohet me tregues dhe element teknikë si harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre etj.

7.2. Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa për evidentimin e pronave të ish-Bashkisë Konispol dhe 2 Njësive Administrative, Xarrë dhe Markat, të kryej inventarizimin, vlerësimin, kontabilizimin, pasqyrimin në aktivet e qëndrueshme të pasqyrave financiare dhe të marrë masa për regjistrimin e të gjitha aseteve në ASHK Dega Sarandë.

Menjëherë dhe në vijimës

7.2.1 .Nga verifikimi rezultoi se: Gjatë viti 2022 me Urdher të Kryetarit të Bashkisë janë ngritur grupe pune të cilat do të bënin evidentimin e aseteve dhe konkretisht

Urdhri nr 51 datë 8.11.2022 “Për ngritjen e grupit të punës i cili do të bëjë inventarizimin e rrugëve dhe Ndricimit Publik”

Urdhri nr 50 datë 08.11.2022 “Për ngritjen e grupit të punës i cili do të bëjë inventarizimin e Infrastrukturës bujqësore(rrugë,kanale kulluese, kanale vaditëse)”

Deri në momentin e verifikimit nuk është kryerë asnjë procedur tjetër për shkak dhe të mungesës së bashkëpunimit edhe nga ASHK Sarandë

Pa zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Konispol, në lidhje me kontratat e qirave për pyje/kullota, rezulton se:

- Nga Bashkia Konispol për periudhën e vitit 2021, janë lidhur **157** kontrata për vlerën prej **4,313,500 lekë**, të cilat janë likuiduar totalisht.

- Kontratat në çdo rast nuk kanë bërë përcaktimin se kujt akti i janë referuar për ndarjen e kullotave (*sipas vendimit të Komisionit të Ndarjes së Kullotave apo vendimit të këshillit të komunës*).

- Kontratat i referohen hartës bashkëlidhur çdo kontrate, kur në fakt nuk administrohet një dokument i tillë, por vetëm një skicë e thjeshtë e cila nuk është miratuar nga titullari i institucionit apo strukturat e tjera të ngarkuara prej tij si p.sh. komisioni për dhënien me qira të pyjeve e kullotave.

- Për të gjitha kontratat, konstatohet se nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë të secilit fermer që ka përfituar kontratë, si dhe nuk ka certifikatë nga Drejtoria e Shërbimeve Veterinare për numrin e regjistrimit të bagëtive dhe matrikullin e tyre, duke mos u dokumentuar numri real i secilit blegtor.

- Lidhja e tyre përgjithësisht është bërë në mungesë të konfirmimit (vërtetimit) të numrit të bagëtive, dokument i cili lëshohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Veterinare, dhe konfirmon regjistrin e bagëtive dhe matrikullit të tyre sipas sistemit “Ruda”, duke mos bërë krahasimin e llojit dhe numrit të krerëve sipas kontratës me regjistrin e DRSHV Vlorë, për secilin vit, dhe eliminimit të rasteve të lidhjes së kontratave me persona të cilët nuk figurojnë të regjistruar në listën e blegtorëve.

- Nuk është kryer inventarizimi kadastrale pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës).

- Nuk është mbajtur bilanci i fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall.

- Nuk është bërë mbajtja, evidentimi, administrimi balancimit të fondit kullimor.

- Lidhur me pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar në kontabilitet, llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie.

- Nuk është kryer procedura e aplikimit të regjistrimit të parcelave në ish-ZVRPP Sarandë, sot ASHK Drejtoria Sarandë.

- Nuk ka plan mbarështimi për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme.

- Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes.

- Nuk janë përcaktuar kritere lidhur me afatin i cili duhet të jetë një vjeçar dhe pagesa të behët e menjëhershme në momentin e kontratës.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 5 “*Planet e Mbarështimit*”, nenin 6 “*Funksionimin e Shërbimit Pyjor*”, nenin 15/2 “*Pronësia e Fondit Pyjor*” të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005; nenet 11 dhe 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 28.3.2001 “*Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*”, ndryshuar me ligjin nr. 10210, datë 25.3.2010; Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “*Për fondin kullimor*”, neni 5, pika 2/b “*Pronësia*”, neni 7 “*Inventarizimi*”, neni 8 “*Regjistrimi*”, neni 9 “*Regjistri i fondi kullimor*”, neni 14 “*Planet e mbarështimit*” dhe neni 15 “*Bimët mjekësore*”, neni 29 “*Organet e kontrollit*”, neni 30 “*Dokumentimi*”, por dhe 33 “*Vlerësimi i dëmit*” dhe 34 “*Kundërvajtjet Administrative*”; VKM nr. 799, datë 29.9.2010, “*Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme*”; VKM nr.22, datë 09.01.2008 “*Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të administrimit të pyllit komunal*”, pika 3 e

vijim, duke mos gjetur zbatim dhe pika 3/3, 5/e, dhe 6 e VKM nr. 396, datë 21.06.2006 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 33-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi; Kryetari i Bashkisë Konispol të kërkoj në Këshillin Bashkiak, një ndryshim të strukturës organizative të bashkisë, duke krijuar Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe pronës publike, pjesë përbërëse e të cilës duhet të jenë Sektori i Bujqësisë dhe Sektori i Pyjeve e Kullotave.

8.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar strukturës organike të miratuar me vendimin nr 4 datë 04.01.2022 konstatohet se nuk është krijuar Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe pronës publike, pjesë përbërëse e të cilës duhet të jenë Sektori i Bujqësisë dhe Sektori i Pyjeve e Kullotave. *Problematik e hasur është mungesa e burime njerëzore tv specializuara pvr përmbylljen e procesit të inventarizimit total të aseteve.*

Pa Zbatuar

8.2. Rekomandimi; Drejtoria e Bujqësisë Bashkia Konispol, të marrë masa që të gjitha kontrata e dhënies me qira të fondit pyjor e kullosor, duhet të krijohet dosje individuale, ku të pasqyrohen qartazi të gjitha të dhënat mbi fermerin, llojin e bagëtive që mbarështon, numrin e tyre, si dhe vërtetimin nxjerrë nga sistemi RUDA me të dhënave e marra nga AZHBR, si dhe parcela kullosore e dhënë në përdorim, sipas skicës së miratuar dhe të bashkëlidhur çdo kontrate.

8.2.1. Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Konispol pergjat vitit 2022 ka bërë plotësimin e dosjeve të fermerëve me dokumentacionin e kërkuar dhe informacionin përkatës për secilin fermer, ku përfshihet kontrata e qerasë për vitin përkatës, vërtetimin nga drejtoria e Bujqësisë për numrin e krerëve dhe llojin, skicën e parcelës kullosore, etj.

Zbatuar

8.3. Rekomandimi; Drejtoria e Bujqësisë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa që kontratat për sipërfaqet kullosore të jepen në raport me numrin e krerëve që disponon çdo subjekt sipas vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Veterinare (dokument i cili duhet të shoqërojë kontratën) dhe të dhënave të AZHBR (sistemi Rud), mbi numrin e krerëve të deklaruar dhe regjistruar në këtë sistem.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.3.1. Nga verifikimi rezultoi se: Kapaciteti mbajtës në krerë i sipërfaqes kullosore të miratuar në Këshillin Bashkiak me Vendim Nr.33, datë 31.08.2022 “Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqeve Pyjore dhe Kullosore në Bashkinë Konispol”, duke u bazuar në inventarin e Ekonomisë Kullosore Konispol, Ekonomisë Kullosore Aliko – Mile dhe Ekonomisë Kullosore Stillo – Vrinë të vitit 1981, kapaciteti mbajtës në krerë të imta është 12,431 krerë dhe të trasha është 364 krerë . Pra numri i krerëve të mbarështuara nga fermerët e Konispolit është më i lartë se sipërfaqja që ne kontraktujmë ndaj dhe fermerët kontraktujnë edhe me Privatën dhe bashkinë fqinje për të plotësuar ne vijën për sipërfaqe e cila ju shërben për krerët që kanë. Për këtë arsye numri i krerëve të deklaruar në kontratat që lidh Bashkia nuk përputhet me numrin e krerëve të deklaruar në AZHBR.

Zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, janë zhvilluar 6 procedura prokurimi me fond limit 109,392 mijë lekë dhe vlerë kontratë të lidhur prej 107,911 mijë lekë, me një kursim në vlerën 1,480 mijë lekë ose 1% e fondit të prokuruar.

- Dosjet e procedurave të prokurimit edhe pse ishin mbyllur në të gjitha fazat e tij, nuk ishin të inventarizuara dhe protokolluara në arkivën e bashkisë Konispol.

- Në auditimin e procedurave të prokurimit për blerje karburanti, rezulton se sasia e përcaktuar për blerje dhe fondi limit përkatës nuk është llogaritur në përputhje me dispozitat ligjore, pasi:

- Disa prej procedura projektet/ preventivat janë hartuar nga specialistët e Drejtorisë së Planifikimit Zhvillim Territorit, Bashkia Konispol dhe miratuar nga titullari i Bashkisë Konispol, por të pa pajisur me licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat

përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.

- Procedura për investime nuk janë të pajisura me leje ndërtimi ose infrastrukurore. Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Konispol dhe përgjegjës të Sektorit të Procedurave janë lidhur kontrata për kryerjen e punimeve pa bërë më parë miratimin dhe marrjen e lejes së ndërtimit ose infrastrukurës.

Veprime në kundërshtim me Kreu III, neni 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar; VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e cila ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, neni 16 “Licenca – kategoritë e punimeve”. Ligji nr. 9154, datë 6/11/2003 “Për Arkivat”; nenin 4/26 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa për kryerjen e projekteve nga persona/subjekte të përcaktuar nga ligji, në mënyrë që të kemi projekte sa më cilësore dhe që paraqesin gjendjen reale të objektit.

9.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: *Referuar sistemit e-Leje konstatohet së, për vitin 2022 Bashkia Konispol ka miratuar lejet e ndërtimit për investimet e kryera na bashkia në 3 rrastë. (ku përfshihen dhe deklaratat paraprake për kryerje punimesh për pjesën e rikonstruksioneve).*

Zbatuar

9.2. Rekomandimi: Sektori i Procedurave të Prokurimit Bashkia Konispol, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021 me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

9.2.1. Nga verifikimi rezultoi se: *Njësia e prokurimit ka kryer procesin e inventarizimit të dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura për periudhën 01.01.2021-31.12.2022*

Zbatuar

9.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të mos lidhë kontrata me subjektet sipërmarrëse dhe fituese të procedurave të prokurimit për investime pa marrë më parë lejen e ndërtimit ose infrastrukturës në Sektorin e Planifikim Zhvillim Territorit, si dhe pa u pajisur me Nipt sekondar për gjithë periudhën e shtrirjes së kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.3.1. Nga verifikimi rezultoi se: *Firma H. SHPK e cila ka kryer punime në territorin e Bashkisë Konispol dhe ishte pajisur me nipt sekondar, po ashtu ka kryer pagesën e taksave në datën 12.07.2022 në vlerën 22,120 lekë*

Zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, rezulton se gjendja e llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në shumën totale prej 24,011,454 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 24,011,454 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*” në mbyllje të vitit 2020 dhe vitit 2021 në të njëjtën vlerë prej 24,011,454 lekë për të cilën nuk ka analiza dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjithashtu në vlerën e saj nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar Bashkisë Konispol dhe të ish Komunave sot Njësitë Administrative “Xarrë” dhe “Markat”, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare

vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 45-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nëpërmjet Drejtorisë Financë/Buxhet të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Pa zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, rezulton se gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 0 lekë. Për këtë gjendje nuk ka analizë dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës në këtë llogari ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, veprime në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 45-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Pa zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, rezulton se gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 dhe 2020 paraqitet në vlerën 0, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se ka kontrata që kanë përfunduar si punime, por likujdimi është shtrirë në dy vite ushtrimore, për të cilat janë kryer pagesa pjesore sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Nga auditimi i kontabilizimeve të veprimeve ekonomike për blerje të aktiveve afatgjata dhe për rastet e investimeve të kryera nga firma sipërmarrëse punimesh, pas kryerjes së testeve në ditarët e bankës, magazinës dhe partitarin e investimeve, kontabilizimet kanë filluar në momentin e pagesave të faturave dhe situacioneve pjesore dhe jo në momentin e mbërritjes së tyre në institucion si dhe me çeljen e fondeve. Nuk kemi kontabilizim të vlerës së kontratave me fillimin e angazhimit.

Për kontratat e investimeve me shtrirje kohore likujdimi përtej vitit ushtrimor rezulton se llogaria 231 “Shpenzime për investime në proces” është debituar dhe kredituar për vlera

pjesore të paguara, duke e mbyllur këtë llogari në mënyrë të gabuar pa u kapitalizuar aktivi deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, kështu në fund të vitit 2021 konstatohet se nga 1 kontratë ka mbetur pa u mbyllur për vlerën prej 78,638,642 lekë, vlerë e cila duhet ti përkiste gjendjes debitore llog. 231 "Shpenzime për investime në proces" me datë 31.12.2021, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Aneksi 1, Pika 2 Klasa 2 si dhe kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 45-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Financës në Bashkinë Konispol të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet t'i evidentojë ato në llogaritë 230-231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" deri në vlerë të plotë, dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave ti kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Pa zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, përcjellë në subjektin Bashkia Konispol me shkresën nr. 97/7, datë 17.06.2021, rezulton se:

- Nuk është respektuar afati 20 ditor dhe 6 mujorë, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.
- Kryetari i Bashkisë nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi raportin e KLSH dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna.
- Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 20 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 20 masa. Nga të pranuarat janë zbatuar 11 masa, janë në proces zbatimi 4 masa dhe nuk janë zbatuar 5 masa.
- Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 7 masa me vlerë **4,776,134 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa me vlerë 495,9410 lekë, janë në proces zbatimi 5 masa 4,280,194 lekë, nga e cila arkëtuar vlera 1,500,000 lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 2,780,194 lekë si dhe janë kontabilizuar.
- Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-ve janë rekomanduar gjithsej **8 masa** me vlerë **33,506,202** lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa me vlerë 1,356,330 lekë, janë në proces zbatimi 2 masa me vlerë 393,424 lekë dhe nuk janë zbatuar 3 masa me vlerë 31,756,448 lekë.
- Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej **4 masa** të cilat janë pranuar **por nuk janë** zbatuar nga subjekti.

veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15, "Të drejtat e KLSH", germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 73-74 dhe Aneks 2.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 97/7, datë 17.6.2021 "Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Konispol", duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht për:*

- **20 masa** organizative, ku 5 prej tyre nuk janë zbatuar fare;
- **5 masa** shpërblim dëmi me vlerë **2,780,194 lekë**.
- **3 masa** shpenzime në kundërshtim me 3-E për vlerën 31,756,448 lekë;
- **4 masa** disiplinore.

13.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Menjëherë

13.2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Situata ngelet e ka ndryshuar referuar vendimit nr 84 datë 30.05.2022 të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Pa zbatuar

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në R.SH” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, nga **Kryetari i Bashkisë Konispol**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit. **Nëpunësi Zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **3,346,309 lekë** ndaj **5 personave**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Konispol për periudhën objekt auditimi janë miratuar 2 leje ndërtimore, nga ku u konstatuan problematika lidhur me përlllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI), si vijon:

1. **Leja e ndërtimit nr. 203/1, datë 25.02.2021** me zhvillues subjektin “L” me objekt “*Magazinë për grumbullimin dhe ruajtjen produkteve*”, me sipërfaqe shtesë 1653 m². Vlera e preventivit fillestarë për të cilën është paguar leja paraqitet në shumën 32,174,586 lekë. Ndërsa preventivi i ri me shtesën kap vlerën 47,134,538 lekë. Për shtesën prej 14,959,952 lekë është llogaritur taksa në vlerën 324,705 lekë (1653 m² x 32,743 lekë/m² x 0.02% sipas VKB x 30% sipas Udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronës së pasurisë së paluajtshme”), e cila është likuajduar me urdhër pagesën datë 22.02.2021 në bankën Kombëtare Tregtare.

Referenca ligjore e përdorur nga DPZHT Bashkia Konispol (*Udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronës së pasurisë së paluajtshme”*), nuk ka lidhje me llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, pasi ky urdhër ka lidhje me shitjen e pronës dhe jo për llogaritjen e TNI për objektet me leje ndërtimi.

Nga sa trajtuam më sipër detyrimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë për shtesën e lejes duhej në shumën **757,778.58 lekë** (1653 m² x 32,743 lekë/m² x 0.02% sipas VKB – 324,705 lekë të likuajduara), vlerë e cila konsiderohet mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë.

2. **Leja e ndërtimit nr. 259/2, datë 8.4.2021** me zhvillues subjektin “A.H” me objekt “*Magazinë për grumbullimin dhe ruajtjen produkteve- I kat*”, me sipërfaqe shtesë 1447 m². Vlera e preventivit fillestarë për të cilën është paguar leja paraqitet në shumën 17,952,544 lekë, ku vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është përlllogaritur në vlerën 359,051 lekë (1447 m² x 32,743 lekë/m² x 0.02% sipas VKB x 30% sipas Udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronës së pasurisë së paluajtshme”), e cila është likuajduar me urdhër pagesën datë 01.4.2021 në Bankën Kombëtare Tregtare.

Referenca ligjore e përdorur nga DPZHT Bashkia Konispol (*Udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronës së pasurisë së paluajtshme”*), nuk ka lidhje me llogaritjen taksës së ndikimit në infrastrukturë, pasi ky urdhër ka lidhje me shitjen e pronës dhe jo për objektet me leje ndërtimi.

Nga sa trajtuam më sipër detyrimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë për shtesën e lejes duhej në shumën **588,531 lekë** ($1447\text{ m}^2 \times 32,743\text{ lekë/m}^2 \times 0.02\%$ sipas VKB – 359,051 lekë të likuajuara), **vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e bashkisë**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, neni 9, i cili ka ndryshuar nenin 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, pika 3, germa (a), si dhe udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016 të Entit të banesave (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 33-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1,Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financë/Buxhet, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjorë në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën **1,346,309 lekë, respektivisht:**

- vlera **757,778 lekë**, ndaj zhvilluesit “L” shpk;

- vlera **588,531 lekë**, ndaj zhvilluesit “A.H”.

Brenda datës 31.08.2022

1.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Konispol me shkresat nr. 1096 prot datë 12.10.2022 ka njoftuar subjektin “L” Sh.p.k për kryerje e pagëses së taksës së ndikimit në infrastruktur referuar ri-llogaritjes bashkëlidhur faturën për arkëtim si dhe me shkresat nr. 1096/1 prot datë 12.10.2022 ka njoftuar subjektin “A.H” për kryerje e pagëses së taksës së ndikimit në infrastruktur referuar ri-llogaritjes bashkëlidhur faturën për arkëtim. Deri në momentin e verifikimit nuk është kryerë asnjë procedur tjetër për kërkimin e shumës, suke u mjaftuar vetëm me njoftimin e subjekteve.

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditim: Nga auditimit, u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas), në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Në këtë njësi vendore operojnë tre subjekte të tregtimit të karburanteve, *respektivisht:*

7. Subjekti “L” ShPK me përfaqësues ligjorë z. D.K, pajisur me autorizim nr. 01, datë 25.6.2020. Sipas të dhënave në dosje, rezulton se nga vlera 1,000,000 lekë është arkëtuar vlera prej 500,000 lekë, kjo sipas konfermes datë 8.6.2020, **duke mbetur për detyrim shuma prej 500,000 lekë, veprim me efekte financiar negativ në buxhet.**

8. Subjekti “H” ShPK me përfaqësues ligjorë z. TH.H, është pajisur me autorizim nr. 03, datë 7.10.2021. Sipas të dhënave në dosje, rezulton se nga vlera 1,000,000 lekë është arkëtuar vlera prej 500,000 lekë, kjo sipas konfermes datë 10.9.2021, **duke mbetur për detyrim shuma prej 500,000 lekë, veprim me efekte financiar negativ në buxhet.**

9. Subjekti “I” ShPK me përfaqësues ligjorë z. P.I. Nga të dhënat e dosjes, rezulton se subjekti ka autorizim nr. 4, datë 10.5.2015 nga ish- Komuna markat dhe nuk është pajisur me autorizim të ri. Nga Sektori i taksave me shkresën nr. Ekstra, datë 5.6.2020 i është bërë kërkesë për paisje për paisje me licensë tregtimi të karburanteve, por që deri me datën e këtij akti nuk është bërë i munduar arkëtimi i vlerës prej 1,000,000 lekë, **veprim me efekte financiar negativ në buxhet, si dhe lejinin e ushtrimit të aktivitet pa licensë.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 ndryshuar me VKM nr. 970, datë 2.12.2015⁸ (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 33-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

⁸ “9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngsbëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që

2.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **2,000,000 lekë** nga **3** subjektet, *respektivisht;*

- **vlera 500,000 lekë** nga subjekti “**L**” ShPK
- **vlera 500,000 lekë** nga subjekti “**H**” ShPK;
- **vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti “**T**” ShPK.

Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriat Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Brenda datës 31.08.2022

2.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Subjekti L SHPK ka kryer pagesen e plote me 2 keste në daten 08.06.2020 dhe daten 27.07.2020 ndërsa H SHPK ka paguar njërin kësht në vlerë 500.000 lekë, kurse subjekti I SHPK nuk ka paguar detyrimin.

Zbatuar pjesërisht

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të regjistrit të procedurave të prokurimit publik me vlera të larta për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021, rezulton se janë realizuar gjithsej **6** procedura me fond limit 109,392 mijë lekë dhe vlerë kontrate 107,911 mijë lekë.

Nga auditimi i **6** procedura me fond limit 109,392 mijë lekë, janë konstatuara në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, të cilat kanë konsistuar në këto mangësi:

a- Në 3 (tre) procedura, kriteret e aplikuar janë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe me tipologjinë e procedurës së zhvilluar, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura.

b- Në 2 (dy), procedura prokurimit, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DST dhe dispozitave të LPP. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurën tjetër me kushte më të favorshme, kjo me qëllim përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondit të prokuruar në vlerën **1,190 mijë lekë**.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim më ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE.

Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera”.

1.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: *Njësi e Prokurimit referuar DST-ve ka bërë argumentuar e kriterëve specifike si dhe i ka ngarkuar në sistemin e prokurimeve publike duke qënë dhe detyrim ligjor tashmë për publikimin e procedurën nga APP.*

Në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik pa economicitet, efizienz dhe efektivitet (3-E) me vlerë 1,190 mijë lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Kryetari i bashkisë nuk ka ndërmar asnjë procedur për nxjerrjen e përgjegjësive në përdorimin e fondeve pa economicitet, efizienz dhe efektivitet (3-E) me vlerë 1,190 mijë lekë.*

Pa zbatuar

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga ASHK, Dega Rajonale Sarandë, u konstatua se.

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2021 – 31.12.2021), kanë paraqitur kërkesë për pajisje me vërtetim mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, gjithsej **36** persona për vlerë takse të llogaritur prej 898,508 lekë, nga e cila deri me datë 31.12.2021, kanë paguar detyrimet 25 persona me vlerë 651,960 lekë dhe nuk kanë paguar detyrimin **11** persona me vlerë **246,548 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetit e Bashkisë Konispol, sipas pasqyrës në faqen 36 të Raport Auditimit

Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Konispol, personat përgjegjës, nuk është bërë asnjë njoftim drejtuar ASHK Dega Sarandë, për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet është marrë ose jo certifikatë pronësie, si dhe të bllokohet procesi i dhënies deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 34-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **246,548 lekë** ndaj **11 personave, respektivisht:** V.M.për vlerën **20,628 lekë**, J.K.për vlerën **44,857 lekë**, A.Z.për vlerën **20,955 lekë**, A.M.për vlerën **19,809 lekë**, B.M. për vlerën **46,495 lekë**, DH.D.për vlerën **2,946 lekë**, K.D.për vlerën **2,946 lekë**, A.P. për vlerën **28,322 lekë**, A.M.për vlerën **16,698 lekë**, M.A. për vlerën **26,521 lekë** dhe J.P. për vlerën **16,371 lekë**

1.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: *Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi deri në momentin e verifikimit nuk është arkëtuar asnjë lekë*

Pa zbatuar

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së Drejtoria Rajonale Sarandë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Brenda datës 31.08.2022

1.2.1. Nga verifikimi rezultoi se: Zyra e taksave ka bërë njoftuar e debitorëve për likuidimin e detyrimeve që kanë kundrejt Bashkisë Konispol me njoftimin perkatose me nr prot ectra në datën 17.12.2022, por nuk është bërë njoftimi i ASHK për vendosjen e barë sigurie mbi pronën.

Zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të marra nga Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve dhe Zyra e Gjendjes Civile si dhe kryqëzimi i tyre, rezulton se planifikimi i taksës së pastrimit nuk është i saktë dhe në raport me numrin e familjeve që duhet të paguajnë atë.

Kështu referuar të dhënave planifikimi i kësaj takse duhet të ishte në vlerën 4,377,050 lekë $\{(150 \text{ subjekte} \times 7,000) + (4376 \text{ familje} \times 1,000)\}$, ose planifikuar më pak për vlerën 882,050 lekë/viti, e ardhur munguar në buxhetin e Bashkisë Konispol, veprim në kundërshtim me VKB nr. 49, datë 24.11.2020 (për subjektet fizik/juridik prej 7,000 lekë/viti dhe abonentët familjarë 1,000 lekë/viti) (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 33-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol në bashkëpunim me institucionet e tjera, të marra masa për evidentimin e saktë të familjeve që duhet të paguajnë taks pastrimi, duke i ngarkuar për detyrimin e taksës së pastrimit të patakshuar dhe arkëtimin në vlerën **882,050 mijë lekë**.

Në hartimin e planit të të ardhurave në vitet vijues

1.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Zyra e taksave vendore i arketon taksën e pastrimit veten atyre familjeve dhe bizneseve të cilave Bashkia Konispol u ofron kete sherbim, nje pjese te bizneseve dhe familje ne Njesine Adminstrative Markat, Bashkia Konispol nuk ja ofron kete sherbim per shkak te terrenit te veshtire.

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga punonjësit e bashkisë për dhënien me qira të pasurive të institucionit të qeverisjes vendore dhe konkretisht kontratat e qirave të lidhura midis Bashkisë Konispol dhe shoqërive private të telefonisë celulare si “V.A” sh.a, dhe të shoqërisë “A” (T. A) ShA, për periudhën objekt auditimi, rezulton se nga ana e Bashkisë Konispol dhe ish Komunës Markat sot Njësi Administrative e Bashkisë Konispol, janë lidhur 3 kontrata qiraje të cilat paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

Nr	Emri Shoqërisë	AFATI	Detyrimi vjetor	Paguar	Papaguar
1	O.T.	11.6.2020 – 10.6.2022	300,000	300,000	0
2	O.T.	27.3.2021 – 26.3.2022	400,000	400,000	0
3	V.A.	9.2019 – 9.2021	800,000	0	800,000
4	V.A.	4.2019 – 6.2021	675,000	0	675,000
	Shuma		2,175,000	700,000	1,475,000

Nga të dhënat e pasqyrës, rezulton se jo të gjitha kompanitë kanë likuiduar detyrimet sipas kontratave të lidhura, ku kompania private “V.A” ShA, nuk ka paguar rregullisht dhe në masën 100% vlerën e kontratës, duke evidentuar një të **ardhura të munguar në shumën 1,475,000 lekë**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e qirasë nr.123 Rep, nr.33/3 Kol, datë 02.02.2015 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 33-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Sektori Shërbimeve Tatimpaguesve Bashkia Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktual të palikujduara nga shoqëria “V.A” në vlerën **1,475,000 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.

Menjëherë

9.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Konispol ka njoftuar subjektet debitorë për pagimin e detyrimit sipas kontratës. Deri në momentin e verifikimit rezultoi se nuk është paguar asnjë lekë si vijon:

Nr	Operatori	Vendndodhja	Vlera	Pagesa	Diferenca
1	V. SH.A	Mile Shales	1,200,000	807,500	392,500
2	V. SH.A	Konispol	1,050,000	0	1,050,000
3	O.T	Mile Shales	300,000	300,000	0
4	O.T	Konispol	400,000	400,000	0
			2,950,000	1,507,500	1,442,500

Burimi: Drejtoria e financës.

Në proces zbatimi

E. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR

1. Gjetje nga auditimi: Nga informacioni i paraqitur nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol dhe auditimi i tyre, u konstatua se gjendja e debitorëve më 31.12.2021 është në shumën 29,902,017 lekë kjo për 1707 subjekte/familje, ku debitorët familjarë zënë 86.2% të totalit të debitorëve, gjë e cila tregon se nga Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve nuk punohet në drejtim të arkëtimit të tyre në zbatim të dispozitave ligjore dhe mundësive të gjetjes së rrugëve, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Konispol.

Në krahasim me vitin 2020, gjendja e debitorëve vjen në rritje, ku nga vlera 27,589,048 lekë në fund të vitit 2020, në fund të vitit 2021 vjen në vlerën 29,902,017 lekë **ose me rritje në shumën 2,312,969 lekë.**

Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, sipas dokumentacionit për arkëtimin e detyrimeve, ka zbatuar vetëm procedurën e njoftimit të subjekteve dhe asnjë procedurë tjetër në zbatim të ligjit për arkëtimin e detyrimeve, **veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhura për Bashkinë Konispol, në vlerën 29,902,017 lekë për vitin 2021.**

Gjithashtu, nga Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve nuk është vijuar me procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, nga ku rezultojnë se **63 subjekte debitorë (fizik/juridik) me vlerë 4,005,851 lekë, janë debitorë në vite.**

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 - Mospagimi i taksave dhe tatimeve, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve) (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 33-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)..

1.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **29,902,017 lekë, si më poshtë vijon:**

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga

ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Të bashkërendojë punën me QKB bashkia Korçë për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Brenda datës 31.12.2022

1.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Gjendja e debitorve më 31.12.2022 paraqitet si vijon:

Emërtimi	Gjendje viti 2021		Shtesa viti 2022		Pakësime viti 2022		Gjendje 31.12.2022	
	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë
Nga subjektet fizik	62	3,967,351			3	114,068	47	4,381,593
Nga subjektet juridik	1	38,500					1	404,800
Nga ambientet familjarë	1644	25,896,136			466	4,141,524	1,601	30,402,805
TOTALI								

Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave vendore

Sa më sipër rezulton se Zyra e taksave ka njoftuar subjektet debitore me shkresat përkatëse. por nuk ka ndërmar asnjë procedur tjetër për bllokimin e llogarive bankare për subjektet debitore

Në proces zbatimi

F. PËR MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masë disiplinore, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi në fillim të auditimit (4,404 mijë lekë), i lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Konispol dhe Komisionit Disiplinor, marrja e masave ligjore e procedurale për fillimin ose jo të procedurave disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale.

Nga verifikimi rezulton se Nuk është ngritur Komisioni Disiplinor për verifikimin rast pas rasti të konstatimeve të KLSH.

Konkluzione dhe rekomandime:

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Konispol, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 257/6 prot, datë 31.05.2022, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, rikërkojmë të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, në cilësinë e Kryetarit të GMS dhe të Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit të Riskut, të marrë masa për:

- Hartimin e Rregullores së re, e cila të jetë në përshtatje me strukturën organike të miratuar për vitin 2021, duke përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë për pozicionet e reja, si pjesë e organigramës aktuale dhe përcaktimin e linjave të raportimit. Të përcaktohen rastet për parandalimin e konfliktit të interesit dhe procedurat e antikorrupsion.

- Hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

- Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë e programeve, realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakt, si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Konispol, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimin të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Sarandë ose Dropull.

3.3 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhetit Bashkia Konispol, të marra masa për përgatitjen e raporteve periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe krahas tyre për uljen e detyrimeve në mënyrë të kontrolluar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen në fund të vitit 2021 të faturave të pa likuiduara të prapambetura në vlerën reale 43,364 mijë lekë, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet Bashkia Konispol, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (*përgjashtuar kufizimet e transfertave specifike nga Ministrinë e Linjës dhe donator të ndryshëm*), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikuiduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

7.1. Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa dhe të krijojë komisionin për marrjen në dorëzim të aseteve jo nën administrim, duke hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim të pronave, i cili duhet të nënshkruhet nga dorëzuesi i pronës dhe përfituesi (Bashkia Konispol), si dhe duhet të shoqërohet me tregues dhe element teknikë si harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre etj.

7.2. Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa për evidentimin e pronave të ish-Bashkisë Konispol dhe 2 Njësi Administrative, Xarrë dhe Markat, të kryej inventarizimin, vlerësimin, kontabilizimin, pasqyrimin në aktivet e qëndrueshme të pasqyrave financiare dhe të marrë masa për regjistrimin e të gjitha aseteve në ASHK Dega Sarandë.

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të kërkoj në Këshillin Bashkiak, një ndryshim të strukturës organizative të bashkisë, duke krijuar Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe pronës publike, pjesë përbërëse e të cilës duhet të jenë Sektori i Bujqësisë dhe Sektori i Pyjeve e Kullotave.

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe nëpërmjet Drejtorisë Financë/Buxhet të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

11.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “*Pyje, Plantacione*” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Financës në Bashkinë Konispol të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet t'i evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerë të plotë, dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave të kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 97/7, datë 17.6.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Konispol”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht për:*

- **20 masa** organizative, ku 5 prej tyre nuk janë zbatuar fare;
- **5 masa** shpërblim dëmi me vlerë **2,780,194 lekë**.
- **3 masa** shpenzime në kundërshtim me 3-E për vlerën 31,756,448 lekë;
- **4 masa** disiplinore.

13.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në R.SH” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, nga **Kryetari i Bashkisë Konispol**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit. **Nëpunësi Zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **3,346,309 lekë** ndaj **5 personave**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Konispol për periudhën objekt auditimi janë miratuar 2 leje ndërtimore, nga ku u konstatuan problematika lidhur me përlllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI), si vijon:

3. Leja e ndërtimit nr. 203/1, datë 25.02.2021 me zhvillues subjektin “L” me objekt “Magazinë për grumbullimin dhe ruajtjen produktesh”, me sipërfaqe shtesë 1653 m². Vlera e preventivit fillestarë për të cilën është paguar leja paraqitet në shumën 32,174,586 lekë. Ndërsa preventivi i ri me shtesën kap vlerën 47,134,538 lekë. Për shtesën prej 14,959,952 lekë është llogaritur taksa në vlerën 324,705 lekë (1653 m² x 32,743 lekë/m² x 0.02% sipas VKB x 30% sipas Udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronës së pasurisë së paluajtshme”), e cila është likuaduar me urdhër pagesën datë 22.02.2021 në bankën Kombëtare Tregtare.

Referenca ligjore e përdorur nga DPZHT Bashkia Konispol (Udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronës së pasurisë së paluajtshme”), nuk ka lidhje me llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, pasi ky urdhër ka lidhje me shitjen e pronës dhe jo për llogaritjen e TNI për objektet me leje ndërtimi.

Nga sa trajtuam më sipër detyrimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë për shtesën e lejes duhej në shumën **757,778.58 lekë** (1653 m² x 32,743 lekë/m² x 0.02% sipas VKB – 324,705 lekë të likuiduara), vlerë e cila konsiderohet mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë.

4. **Leja e ndërtimit nr. 259/2, datë 8.4.2021** me zhvillues subjektin “A.H” me objekt “Magazinë për grumbullimin dhe ruajtjen produkteve- I kat”, me sipërfaqe shtesë 1447 m². Vlera e preventivit fillestarë për të cilën është paguar leja paraqitet në shumën 17,952,544 lekë, ku vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është përlogaritur në vlerën 359,051 lekë (1447 m² x 32,743 lekë/m² x 0.02% sipas VKB x 30% sipas Udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronës së pasurisë së paluajtshme”), e cila është likuaduar me urdhër pagesën datë 01.4.2021 në Bankën Kombëtare Tregtare.

Referenca ligjore e përdorur nga DPZHT Bashkia Konispol (Udhëzimit nr. 29, datë 30.7.2018 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronës së pasurisë së paluajtshme”), nuk ka lidhje me llogaritjen taksës së ndikimit në infrastrukturë, pasi ku urdhër ka lidhje me shitjen e pronës dhe jo për objektet me leje ndërtimi.

Nga sa trajtuam më sipër detyrimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë për shtesën e lejes duhej në shumën **588,531 lekë** (1447 m² x 32,743 lekë/m² x 0.02% sipas VKB – 359,051 lekë të likuaduar), **vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e bashkisë**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, neni 9, i cili ka ndryshuar nenin 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, pika 3, germa (a), si dhe udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016 të Entit të banesave (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 33-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financë/Buxhet, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën **1,346,309 lekë, respektivisht:**

- vlera **757,778 lekë**, ndaj zhvilluesit “L” shpk;
- vlera **588,531 lekë**, ndaj zhvilluesit “A.H”.

Brenda datës 31.08.2022

1.1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Konispol me shkresat nr. 1096 prot datë 12.10.2022 ka njoftuar subjektin “L” Sh.p.k për kryerje e pagëses së taksës së ndikimit në infrastruktur referuar ri-llogaritjes bashkëlidhur faturën për arkëtim si dhe me shkresat nr. 1096/1 prot datë 12.10.2022 ka njoftuar subjektin “A.H” për kryerje e pagëses së taksës së ndikimit në infrastruktur referuar ri-llogaritjes bashkëlidhur faturën për arkëtim. Deri në momentin e verifikimit nuk është kryerë asnjë procedur tjetër për kërkimin e shumës, suke u mjaftuar vetëm me njoftimin e subjekteve.

Zbatuar pjesërisht

2.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **2,000,000 lekë** nga **3** subjektet, *respektivisht;*

- vlera **500,000 lekë** nga subjekti “L” ShPK
- vlera **500,000 lekë** nga subjekti “H” ShPK;
- vlera **1,000,000 lekë** nga subjekti “T” ShPK.

Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriat Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Brenda datës 31.08.2022

4.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Subjekti L SHPK ka kryer pagesën e plote me 2 keste në datën 08.06.2020 dhe datën 27.07.2020 ndërsa H SHPK ka paguar njërin kësht në vlerë 500.000 lekë, kurse subjekti I SHPK nuk ka paguar detyrimin.

Zbatuar pjesërisht

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik pa economicitet, efizienz dhe efektivitet (3-E) me vlerë 1,190 mijë lekë.

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA

1.2. Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **246,548 lekë** ndaj **11 personave**, *respektivisht:* V.M.për vlerën **20,628 lekë**, J.K.për vlerën **44,857 lekë**, A.Z.për vlerën **20,955 lekë**, A.M.për vlerën **19,809 lekë**, B.M. për vlerën **46,495 lekë**, DH.D.për vlerën **2,946 lekë**, K.D.për vlerën **2,946 lekë**, A.P. për vlerën **28,322 lekë**, A.M.për vlerën **16,698 lekë**, M.A. për vlerën **26,521 lekë** dhe J.P. për vlerën **16,371 lekë**

1.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: *Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi deri në momentin e verifikimit nuk është arkëtuar asnjë lekë*

Pa zbatuar

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së Drejtoria Rajonale Sarandë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohej bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Brenda datës 31.08.2022

1.2.1. Nga verifikimi rezultoi se: *Zyra e taksave ka bërë njoftuar e debitorëve për likuidimin e detyrimeve që kanë kundrejt Bashkisë Konispol me njoftimin perkatëse me nr prot ectra në datën 17.12.2022, por nuk është bërë njoftimi i ASHK për vendosjen e barë sigurie mbi pronën.*

Zbatuar pjesërisht

F. PËR MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masë disiplinore, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi në fillim të auditimit (4,404 mijë lekë), i lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Konispol dhe Komisionit Disiplinor, marrja e masave ligjore e procedurale për fillimin ose jo të procedurave disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale.

Nga verifikimi rezultoi se *Nuk është ngritur Komisioni Disiplinor për verifikimin rast pas rasti të konstatimeve të KLSH.*

Titulli i gjetjes: *Bashkia Konispol është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

Situata: - Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 257/6 prot, datë 31.05.2022 i ka dërguar Bashkinë Konispol Vendimin **nr. 84, datë 30.05.2022**, për përmirësimin e gjendjes, janë rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 21 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 21 masa. Nga të pranuarat janë zbatuar 7 masa, janë në proces zbatimi 2 masa janë zbatuar pjesërisht 2 masa si dhe nuk janë zbatuar 10 masa organizative.

- *Për shpërblim dëmi janë rekomanduar* 2 masa me vlerë **3,346,309 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga vlera e pranuar është arkëtuar vlera **500,000 lekë** nga subjekti *L SHPK si dhe nuk është arkëtuar vlera 2,846,309 lekë për të cilat bashkia Konispol ka njoftuar subjektet që janë debitorë.*

- *Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-ve* janë rekomanduar gjithsej **2 masa** me vlerë **1,190 mijë** lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht dhe nuk është zbatuar 1 masa me vlerë **1,190 mijë** lekë.

- *Për masa disiplinore*, është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Konispol ti Komisionit Disiplinor, marrja e masave ligjore e procedurale për fillimin ose jo të procedurave disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” mas e cila nuk është zbatuar nga subjekti.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 73-74 dhe Aneks 2.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Kriteret: Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

Shkaku: Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Konispol me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi

Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 257/6 prot, datë 31.05.2022, “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Konispol”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht:*

Për 10 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara dhe 2 masa organizative të zbatuara pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, në cilësinë e Kryetarit të GMS dhe të Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit të Riskut, *të marrë masa për:*

- Hartimin e Rregullores së re, e cila të jetë në përshtatje me strukturën organike të miratuar për vitin 2021, duke përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë për pozicionet e reja, si pjesë e organigramës aktuale dhe përcaktimin e linjave të raportimit. Të përcaktohen rastet për parandalimin e konfliktit të interesit dhe procedurat e antikorrupsion.

- Hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

- Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë e programeve, realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakt, si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Konispol, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Sarandë ose Dropull.

3.3 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhetit Bashkia Konispol, të marra masa për përgatitjen e raporteve periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe krahas tyre për uljen e detyrimeve në mënyrë të kontrolluar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen në fund të vitit 2021 të faturave të pa likuiduara të prapambetura në vlerën reale 43,364 mijë lekë, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet Bashkia Konispol, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (*përyjashtuar kufizimet e transfertave specifike nga Ministrinë e Linjës dhe donator të ndryshëm*), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikujduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

7.1. Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa dhe të krijojë komisionin për marrjen në dorëzim të aseteve jo nën administrim, duke hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim të pronave, i cili duhet të nënshkruhet nga dorëzuesi i pronës dhe përfituesi (Bashkia Konispol), si dhe duhet të shoqërohet me tregues dhe element teknikë si harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre etj.

7.2. Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa për evidentimin e pronave të ish-Bashkisë Konispol dhe 2 Njësi Administrative, Xarrë dhe Markat, të kryej inventarizimin, vlerësimin, kontabilizimin, pasqyrimin në aktivet e qëndrueshme të pasqyrave financiare dhe të marrë masa për regjistrimin e të gjitha aseteve në ASHK Dega Sarandë.

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të kërkojë në Këshillin Bashkiak, një ndryshim të strukturës organizative të bashkisë, duke krijuar Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe pronës publike, pjesë përbërëse e të cilës duhet të jenë Sektori i Bujqësisë dhe Sektori i Pyjeve e Kullotave.

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin të aktiveve në llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe nëpërmjet Drejtorisë Financë/Buxhet të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

11.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Financës në Bashkinë Konispol të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet t’i evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerë të plotë, dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave të kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 97/7, datë 17.6.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Konispol”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht për:*

- **20 masa** organizative, ku 5 prej tyre nuk janë zbatuar fare;
- **5 masa** shpërblim dëmi me vlerë **2,780,194 lekë**.
- **3 masa** shpenzime në kundërshtim me 3-E për vlerën 31,756,448 lekë;
- **4 masa** disiplinore.

13.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Për 2 masa shpërblim dëmi në vlerë **2,846,309 lekë** për të cilat Bashkia Konispol ka njoftuar subjektet që janë debitorë, të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës/Buxhet, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën **1,346,309 lekë**, *respektivisht:*

- **vlera 757,778 lekë**, ndaj zhvilluesit “L” shpk;
- **vlera 588,531 lekë**, ndaj zhvilluesit “A.H”.

2.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **1,500,000 lekë** nga 2 subjektet, *respektivisht;*

- **vlera 500,000 lekë** nga subjekti “H” ShPK;
- **vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti “T” ShPK.

Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriati Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Për 1 masa në shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E në vlerë 1,190 mijë lekë, e cila është konsideruar e pa zbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve

të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E) me vlerë 1,190 mijë lekë.

III. KONKLuzion I Përgjithshëm

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, rezulton se:

Rregullorja e Brendshme nuk është plotësisht në përshtatje me strukturën organike aktuale, pasi mungojnë përcaktimet e detyrave dhe përgjegjësi të Sektorit të Menaxhimit të Aseteve. Kështu në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Blegtorisë është shtuar pozicioni “*Inspektor për mbrojtjen e konsumatorit*” dhe në Drejtorinë Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit, janë shtuar pozicionet “*Specialist inxhinier hidroteknik*” dhe “*Sekretar i sekretarisë teknike*”, pozicione të cilat mungojnë në rregullore.

Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të Brendshëm. Nga 3 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

“Menaxhimi i Riskut”

- Nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut.
- Mungon urdhri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut.
- Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.
- Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut.
- Nuk janë hartuar planet e veprimit për menaxhimin e riskut
- Nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.
- Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Mungon sistemi i “IT” dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (BACK-UP)
- Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar “IT” të ndryshme në sektorë të ndryshëm, si dhe nuk ka plan investimesh për programet e “IT”. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit, nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakt dhe produkti.

- Rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës, veprime në kundërshtim me ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8 pika 8 shkronja (d, e), Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 24-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, me atributet e Kryetarit të GMS, si dhe Nëpunësi Autorizues dhe Koordinatori i Riskut, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakt. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hartimin dhe funksionimin e strukturës organike të Bashkisë Konispol, nuk gjejmë të pasqyruar strukturën e Auditit të Brendshëm (AB), kjo për mungesë të specialistëve dhe nuk ka lidhur as aktmarrëveshje me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja (c), si dhe nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6 shkronja (a). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 24-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Konispol, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Sarandë ose Dropull.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se buxheti në fillim të vitit është planifikuar për vlerën 177,584 mijë lekë . Gjatë vitit buxheti është shtuar për vlerën 182,179 mijë lekë pra plani sipas thesarit është për vlerën gjithsej 359,763 mijë lekë, gjë që tregon se në planin fillestarë këto fonde nuk janë marrë në konsideratë, të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet jo real, të qëndrueshëm dhe efektiv. Realizimi i buxhetit sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2022 nga 359,763 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 317,716 mijë lekë ose në masën 88 %, . Detyrimet e papaguara për vitin 2022 sipas bilancit janë në shumën 14,756,764 lekë ose në masën 6.48 % të shpenzimeve të planifikuara, ku peshën më të madhe e zënë detyrimet për energjinë elektrike, telefon pastrimin në vlerën 12,208,920 lekë ose 83 % e totalit. Për vitin 2022 nuk janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetimit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe

objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42, me Udhëzimin e MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2. faqe 33-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 4,420,879 lekë si në mbyllje të bilancit të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022, aktive për të cilat nuk është kryer inventar fizik, referuar Inventarit kontabël vlera 1,598,199 lekë që i përket gjendjes së aktiveve të kësaj llogarie në Aparatin e Bashkisë në vlerën 976,468 lekë, shkollat e Bashkisë Konispol në vlerën 336,193 lekë dhe NJA Xarrë në vlerën 285,538 lekë. Në gjendjen e llogarisë 32 “Inventari i imët” sipas inventarit kontabël të NJA Markat, e cila paraqitet në një vlerë sintetike prej 2,822,680 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo situatë është trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Konispol i bilancit të vitit 2015 të mbylljes së ish-komunës Konispol i paraqitur me probleme dhe pa analiza për këto aktive. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për të saktësuar gjendjen reale dhe vlerën kontabël të aktiveve të pasqyruara në llog. 32 “Inventari i imët” për shumën 4,420,879 lekë, të bëhet inventarizimi si dhe të nxirren diferencat mes vlerave në kontabilitet dhe vlerave të inventarit fizik, të kryhet vlerësimi i inventarit dhe procedurat e mëtejshme ligjore mbështetur në UMF.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 29,902,017 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 35,189,198 lekë, me rritje për vlerën 5,287,181 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët, sipas akt akordimit midis Sektorit të Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike. Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” konstatohet se Drejtoria e Financës nuk ka bërë kontabilizimin e detyrimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas Vendimit të Kryetarit të dërguara në Bashkinë Konispol edhe pse kanë dalë urdhër zhdëmtimeve përkatëse, të dala nga Kryetari i Bashkisë sipas planit të veprimit. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.

44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Drejtorja e Financë të marrin masa për kontabilizimin e masave shpërblim dëmi të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dërguar në Bashkinë Konispol me shkresat përkatëse.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se llogarit 210 “Toka, Troje, Terrene”, paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 24,011,454 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 24,011,454 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2020 dhe vitit 2021 në të njëjtën vlerë prej 24,011,454 lekë, 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 0 lekë. Për këto vlerë nuk ka analiza dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjithashtu në vlerat e tyre nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar Bashkisë Konispol dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative “Xarrë” dhe “Markat”. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogarit . 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstrukione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 383,664,972 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 368,221,963 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 497,239,440 lekë. Për këto AAGJM nuk është kryer inventar fizik. Në gjendjen së llog. 212“Ndërtesa” është vlera kontabël e cila është e pa analizuar aktiv për aktiv. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Markat si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë Konispol. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Kryetari I Bashkisë Konispol, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” për NJA Markat dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave për procedurat e zhvilluara për vitin 2022, gjithsej 5 procedura, me fond limit në vlerën 88,713 mijë lekë, mbi bazën e materialitetit u vlerësuan për aditim audituan 3 procedura me fond limit 30,564 mijë lekë, u konstatua se:

a- Në **3 procedura** raste me fond limit 30,564 mijë lekë, pasi kriteret e aplikuar janë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe me tipologjinë e procedurës së zhvilluar, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura.

-Procedura me objekt “Zgjerim i varrezave të fshatit Mursi”, me vlerë të fondit limit 4,108 mijë lekë dhe vlerë kontrate 3,405 mijë lekë;

-Procedura me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor, Konispol”, me vlerë të fondit limit 8,917 mijë lekë dhe vlerë kontrate 7,678 mijë lekë;

-Procedura me objekt “Mbrojtje lumore në lumin “Pavëll” pranë urës së Bogazit”, me vlerë të fondit limit 17,539 mijë lekë dhe vlerë kontrate 14,153 mijë lekë;

b- Në **2 procedura** prokurimit, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DST dhe dispozitave të LPP. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurën tjetër me kushte më të favorshme., konkretisht:

-Procedura me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugor, Konispol”, me vlerë të fondit limit 8,917 mijë lekë dhe vlerë kontrate 7,678 mijë lekë;

-Procedura me objekt “Mbrojtje lumore në lumin “Pavëll” pranë urës së Bogazit”, me vlerë të fondit limit 17,539 mijë lekë dhe vlerë kontrate 14,153 mijë lekë; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 61-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE.

Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

8.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 rezultoi se: Bashkia Konispol, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2022 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Konispol SHA me NUIS “LV” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi

i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 299,600 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 299,600,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Konispol në “Ujësjellës Kanalizime Konispol SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël të vitit 2022, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjellës Kanalizime Konispol Sh.a me vlerë 299,600,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, konstatohet se Drejtoria e Financës nuk disponon listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje”, nuk jep informacion të plotë, pasi mungon afati i fillimit dhe mbarimit të garancisë së vlerës 5% të punimeve për subjektet private. Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende. Në pasqyrat financiare të vitit 2022 vlera e llogarisë 466 është në vlerën 16,373,031 lekë sipas aneksit nr. 7 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, rezulton se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj me agjentët tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Konispol (brenda datës 5 të çdo muaji), gjë e cila konstatohet nga fakti se në vitin 2022 nuk ka asnjë arkëtim. Gjithashtu rakordimi nuk është mbajtur dhe me DRSHTRR Sarandë në lidhje me numrin e mjeteve që ka në përdorim kjo njësi vendore, sa nga këto mjete janë aktiv në gjendje pune, sa nuk janë në gjendje pune, sa paguajnë dhe sa nuk paguajnë dhe nëse derdhjet në buxhet bëhen sipas afateve ose jo.

Për sa më sipër, Bashkia Konispol nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Konispol, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me Neni 117⁹ të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 39-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi Sektori i Shërbimeve tatimpaguese Bashkia Konispol, të marrë masa për:

- Evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizimin e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.
- Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mbledhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezultojnë se bashkia Konispol nuk ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve, dërguar nga KLSH-ja me shkresën nr. 257/6 prot, datë 31.5.2022, si më poshtë vijon:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 21 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 21 masa. Nga të pranuarat janë zbatuar 7 masa, janë në proces zbatimi 2 masa janë zbatuar pjesërisht 2 masa si dhe nuk janë zbatuar 10 masa organizative.

- Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 2 masa me vlerë **3,346,309 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga vlera e pranuar është arkëtuar vlera **500,000 lekë** nga subjekti *L SHPK* si dhe nuk është arkëtuar vlera **2,846,309 lekë** për të cilat bashkia Konispol ka njoftuar subjektet që janë debitorë.

- Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-ve janë rekomanduar gjithsej **2 masa** me vlerë **1,190 mijë lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht dhe nuk është zbatuar 1 masa me vlerë **1,190 mijë lekë**.

- Për masa disiplinore, është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Konispol ti Komisionit Disiplinor, marrja e masave ligjore e procedurale për fillimin ose jo të procedurave disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” masë e cila nuk është zbatuar nga subjekti.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 76-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

⁹ “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifatat e mbledhura, apo i shmangjet mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së përmbledhura apo të shmangur.”

12.1.Rekomandimi Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa për përsheptimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 257/6 prot datë 31.5.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Konispol”, respektivisht:

Për 10 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara dhe 2 masa organizative të zbatuara pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, në cilësinë e Kryetarit të GMS dhe të Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit të Riskut, të marrë masa për:

- Hartimin e Rregullores së re, e cila të jetë në përshtatje me strukturën organike të miratuar për vitin 2021, duke përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë për pozicionet e reja, si pjesë e organigramës aktuale dhe përcaktimin e linjave të raportimit. Të përcaktohen rastet për parandalimin e konfliktit të interesit dhe procedurat e antikorrupsion.

- Hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

- Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë e programeve, realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakt, si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Konispol, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Sarandë ose Dropull.

3.3 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhetit Bashkia Konispol, të marra masa për përgatitjen e raporteve periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe krahas tyre për uljen e detyrimeve në mënyrë të kontrolluar të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen në fund të vitit 2021 të faturave të pa likuiduara të prapambetura në vlerën reale 43,364 mijë lekë, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet Bashkia Konispol, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përrjashtuar kufizimet e transferta specifike nga Ministritë e linjës dhe donator të ndryshëm), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikujduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

7.1. Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa dhe të krijojë komisionin për marrjen në dorëzim të aseteve jo nën administrim, duke hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim të pronave, i cili duhet të nënshkruhet nga dorëzuesi i pronës dhe përfituesi (Bashkia Konispol), si dhe duhet të shoqërohet me tregues dhe element teknikë si harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre etj.

7.2. Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa për evidentimin e pronave të ish-Bashkisë Konispol dhe 2 Njësi Administrative, Xarrë dhe Markat, të kryej inventarizimin, vlerësimin, kontabilizimin, pasqyrimin në aktivet e qëndrueshme të pasqyrave financiare dhe të marrë masa për regjistrimin e të gjitha aseteve në ASHK Dega Sarandë.

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të kërkoj në Këshillin Bashkiak, një ndryshim të strukturës organizative të bashkisë, duke krijuar Drejtorinë e Administrimit të

Aseteve dhe pronës publike, pjesë përbërëse e të cilës duhet të jenë Sektori i Bujqësisë dhe Sektori i Pyjeve e Kullotave.

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nëpërmjet Drejtorisë Financë/Buxhet të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

11.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Financës në Bashkinë Konispol të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet t’i evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerë të plotë, dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave ti kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 97/7, datë 17.6.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Konispol”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, respektivisht për:

- **20 masa** organizative, ku 5 prej tyre nuk janë zbatuar fare;
- **5 masa** shpërblim dëmi me vlerë **2,780,194 lekë**.
- **3 masa** shpenzime në kundërshtim me 3-E për vlerën 31,756,448 lekë;
- **4 masa** disiplinore.

13.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Për 2 masa shpërblim dëmi në vlerë 2,846,309 lekë për të cilat Bashkia Konispol ka njoftuar subjektet që janë debitorë, të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

1.1,Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financë/Buxhet, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën **1,346,309 lekë**, respektivisht:

- **vlera 757,778 lekë**, ndaj zhvilluesit “L” shpk;
- **vlera 588,531 lekë**, ndaj zhvilluesit “A.H”.

2.1. Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **1,500,000 lekë** nga 2 subjektet, respektivisht;

- **vlera 500,000 lekë** nga subjekti “H” ShPK;
- **vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti “I” ShPK.

Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektorati Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Për 1 masa në shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E në vlerë 1,190 mijë lekë, e cila është konsideruar e pa zbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik pa economicitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E) me vlerë 1,190 mijë lekë.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **276,684 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se me procesverbal nr. 06.01.2023, datë 25.8.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 2 OE, me PV datë 16.01.2023 nga KVO është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, ku në fund KVO ka vendosur kualifikimin e të dy OE, duke shpallur fitues shoqërinë “J.C” shpk me ofertë 13,834,205 lekë pa TVSh me ofertë më leverdishme. me datë 18.01.2023 është bërë njoftim klasifikimi dhe ngarkuar në sistemin njoftimi i fituesit në zbatim të nenit 32, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021. Pas publikimit në APP të njoftimit paraprak të fituesit dhe në pritje së afateve të ankimimit OE “J.C” shpk është tërhequr nga oferta nëpërmjet një mesazhit në sistemin datë 28.01.2023. Nga Bashkia Konispol (Sektori i prokurimeve dhe financës), nuk është vepruar për konfiskimin e sigurimit të ofertës, veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e bashkisë për shumën **276,684 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 61-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financë/Buxhet, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e sigurimit të ofertës në vlerën **276,684 lekë**.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMININ E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga ASHK, Dega Rajonale Sarandë, u konstatua se

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2022 – 31.12.2022), kanë paraqitur kërkesë për pajisje me vërtetim mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, gjithsej **7** persona për vlerë takse të llogaritur prej 195,900 lekë, nga e cila deri me datë 31.12.2022 kanë paguar detyrimet 7 persona me vlerë 195,900 lekë. Referuar periudhës përpara vitit 2022 rezulton se gjendja

debitorë ngelet e pa ndryshuar. Pra nuk kanë paguar detyrimin **11** persona me vlerë **246,548 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetit e Bashkisë Konispol. Paraqitet sipas aneksit nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Konispol, personat përgjegjës, nuk është bërë asnjë njoftim drejtuar ASHK Dega Sarandë, për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet nëse është marrë ose jo certifikatë pronësie. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, neni 23, pika 2/1 e nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 39-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **246,548 lekë** ndaj **11 personave**.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit, u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti *(sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas)*, në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Në këtë njësi vendore operojnë tre subjekte të tregtimit të karburanteve, *respektivisht:* 10. Subjekti “**L**” ShPK me përfaqësues ligjorë z. *D.K.*, pajisur me autorizim nr. 01, datë 25.6.2020. Sipas të dhënave në dosje, rezulton se nga vlera 1,000,000 lekë është arkëtuar vlera prej 1,000,000 lekë (konferma datë 8.6.2020 dhe 27.07.2020). Subjekti “**H**” ShPK me përfaqësues ligjorë z. *TH.H.*, është pajisur me autorizim nr. 03, datë 7.10.2021. Sipas të dhënave në dosje, rezulton se nga vlera 1,000,000 lekë është arkëtuar vlera prej 500,000 lekë (konferma datë 10.9.2021), **duke mbetur për detyrim shuma prej 500,000 lekë, si mungesë të ardhurash.** Subjekti “**I**” ShPK me përfaqësues ligjorë z. *P.I.* Nga të dhënat e dosjes, rezulton se subjekti ka autorizim nr. 4, datë 10.5.2015 nga ish- Komuna Markat nuk është pajisur me autorizim të ri. Nga Sektori i taksave me shkresën nr. *ekstra*, i është bërë kërkesë për pajisje me licencë tregtimi të karburanteve, por nuk është bërë i munduar arkëtimi i vlerës prej 1,000,000 lekë, **vlerë e cila konsiderohet mungesë të ardhurash në buxhet, si dhe lejimin e ushtrimit të aktivitet pa licencë.**

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 ndryshuar me VKM nr. 970, datë 2.12.2015¹⁰ *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 75-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi Sektori i Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,500,000 lekë** nga 2 subjektet, *respektivisht;*
- **vlera 500,000 lekë** nga subjekti “**H**” ShPK;
- **vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti “**I**” ShPK.

Menjëherë dhe në vijimësi

¹⁰ “9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera”.

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga punonjësit e bashkisë për dhënien me qira të pasurive të institucionit të qeverisjes vendore dhe konkretisht kontratat e qirave të lidhura midis Bashkisë Konispol dhe shoqërive private të telefonisë celulare si “V.A” sh.a, dhe të shoqërisë “A” (T. A) sh.a, për periudhën objekt auditimi, në lidhje me mënyrën e lidhjes së kontratave, të përcaktimit të tarifave, të arkëtimit të detyrimeve nga dhënia e objekteve të ndryshme me qira rezulton se nga ana e Bashkisë Konispol dhe ish Komunës Markat sot Njësi Administrative e Bashkisë Konispol, janë lidhur 3 kontrata qiraje, rezulton se jo të gjitha kompanitë kanë likuiduar detyrimet sipas kontratave të lidhura, ku kompania private “V.A” sh.a, nuk janë kryer rregullisht pagesat në masën 100%, duke evidentuar një të **ardhura të munguar në shumën 1,475,000 lekë nga kompania “V.A”**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e qirasë nr.123 Rep, nr.33/3 Kol, datë 02.02.2015. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 75-76 të Raportit të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Sektori Shërbimeve Tatimpaguesve Bashkia Konispol në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktual të palikujduara nga shoqëria “V.A” në vlerën **1,475,000 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.**

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR

1. Gjetje nga auditimi: Nga informacioni i paraqitur nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol dhe auditimi i tyre, u konstatua se gjendja e debitorëve sipas periudhave objekt auditimi është si vijon: Gjendja e debitorëve më 31.12.2021 është në shumën 29,902,017 lekë kjo për 1707 subjekte/familje, ku debitorët familjarë zënë 86.2% të totalit të debitorëve, gjë e cila tregon se nga Zyra e taksave Konispol nuk punohet në drejtim të arkëtimit të tyre në zbatim të dispozitave ligjore dhe mundësive të gjetjes së rrugëve, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Konispol.

Në krahasim me vitin 2021, gjendja e debitorëve vjen në rritje, ku në fund të vitit 2021 vjen në vlerën 29,901,987 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 35,189,198 lekë **ose me rritje në vlerën 5,287,211 lekë.**

Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, sipas dokumentacionit për arkëtimin e detyrimeve, ka zbatuar vetëm procedurën e njoftimit të subjekteve dhe asnjë procedurë tjetër në zbatim të procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve, **veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhura për Bashkinë Konispol, në vlerën 35,189,198 lekë për vitin 2022.**

Gjithashtu, nga Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve nuk është vijuar me procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, ku rezultojnë se **48** subjekte debitorë (fizik/juridik) me vlerë **4,786,393 lekë**, janë debitorë në vite. Në kundërshtim me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*¹¹, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), duke u bërë përgjegjës për rritjen e nivelit të borxhit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 39-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

¹¹ “Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

1.1. Rekomandimi: Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve Bashkia Konispol, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **35,189,198 lekë**, si më poshtë vijon:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Sarandë për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi.

E. MASA DISIPLINORE

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Konispol, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05/03/2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale, respektivisht:

1. **Z. A.B.** me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit.

2. **Znj. M.H.** me detyrë Specialiste Juriste.

3. **Z. D.K.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit të Tatimpaguesve.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *konkretisht në praktikat:*

- “Zgjerim i varrezave të fshatit Mursi”, me fond limit 4,107,687 lekë.

- “Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugorë, Konispol”, me fond limit 8,917,090 lekë.

- “Mbrojtja lumore në lumin Pavell-pranë urës së Bogazut”, me fond limit 17,539,343 lekë.

4. **Z. D.LL.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit.

5. **Z. L.B.** me detyrë Specialist Inxhinier Ndërtimi.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, *konkretisht në praktikat:*

- “Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit rrugorë, Konispol”, me fond limit 8,917,090 lekë.

- “Mbrojtja lumore në lumin Pavell-pranë urës së Bogazut”, me fond limit 17,539,343 lekë.

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Konispol, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT